

1 E mërkurë, 29 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal të katër të akuzuarit janë të pranishëm në sallën
13 e gjyqit sot.

14 Përpara se të fillojmë me vazhdimin e dëshmisë së
15 Dëshmitarit të Prokurorisë 04743, ka një çështje paraprake që
16 Trupi Gjykses dëshiron që ta trajtojë.

17 Znj. Sekretare e seancës ju lutem na kaloni në seancë
18 private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 jemi në seancë të hapur.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
24 procesverbal, Avokati kujdestar për Dëshmitarin 04743 është i
25 disponueshëm jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se Dëshmitari

1 04743 dëshiron që të marrë këshillime prej tij, mund ta bëjë
2 këtë gjë. Megjithëse e kuptojmë që do të ketë ndonjë vonesë të
3 vogël në qoftë se do jetë e nevojshme që Dëshmitari të
4 kontaktojë me Avokatin e vet.

5 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

6 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
8 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj që duhet t'i përgjigjeni
9 pyetjeve me fjali të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e
10 kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i kërkonit Avokatit përkatës
11 që ta përsërisë pyetjen, ose mund t'i thoni që nuk e kuptuat
12 pyetjet dhe avokati përkatës të mund të japë sqarime të tjera
13 lidhur me këtë. Po ashtu duhet që të jepni bazën e njohurive
14 për faktet dhe rrethanat në të cilat do të pyeteni.

15 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrimin për të thënë të
16 vërtetën ashtu sikurse e deklaruat në betimin solemn dje.
17 Gjithashtu ju kujtoj që garancitë që ju janë dhënë dje, ju
18 janë dhënë të hënën nga Trupi Gjykses, domethënë,
19 përgjegjësisht që përgjigjet e dhëna prej jush ndaj pyetjeve
20 përkatëse nuk do të përdoren as në mënyrë të drejtpërdrejtë,
21 as në mënyrë të tërthortë, kundër ndonjë ndjekje penale
22 pasuese nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në përjashtim të
23 parashikimeve të nenit 115(2) i ligjit dhe rregulla 65, janë
24 ende në fuqi, pra, garanci të cilat janë dhënë për ju.
25 Gjithashtu, dua t'ju kujtoj që refuzimi për të dhënë dëshmi

1 mund të sanksionohet me vendosjen e një gjobe ndaj jush.

2 Ju lutem, duhet që të flisni pranë mikrofonit, duhet të bëni
3 një pauzë prej pesë sekondash përpara se të përgjigjeni në
4 pyetje në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit.

5 Nëse e ndieni të nevojshme që të bëni pushim, na e thoni
6 këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet përkatëse.

7 Z. Roberts do të vazhdojë me juve.

8 Z. Roberts, fjala për ju.

9 DËSHMITARI: Naser Krasniqi [Vijon]

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts: [Vazhdim]

11 Z. ROBERTS: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjes, z. Krasniqi.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

14 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim]

16 PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur me rastin Krojmirë,
17 të cilin ju e diskutuat me Prokurorinë dje.

18 Pra, ky është një rast i cili ka të bëjë me Ajvaz
19 Korpuzi, Arsim Haziri, dhe dy persona të tjerë. A është e
20 saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Kanë të bëjnë pesë persona.

22 PY. Po, pesë persona që unë i përmenda megjithëse e kisha pak
23 problematik shqiptimin.

24 PË. Saktë.

25 PY. Sipas raportit që ne pamë dje - dhe për procesverbal

1 është prova P2010 -- pra, 2010, në faqen 083064 - tre prej
2 këtyre personave kanë raportuar përpara policisë ushtarake në
3 Kleçkë në orën 3.00, në datën 30 prill 1999, dhe më pas janë
4 çarmatosur. A ka ndodhur kështu, a është e saktë kjo,
5 Dëshmitar?

6 PË. E di që janë ndaluar dhe janë çarmatosur të pestë, mirëpo
7 tani nuk mund t'i ndaj me emra se cili më herët dhe cili më
8 vonë.

9 PY. Në rregull. Është e kuptueshme. Pas kësaj kohe, i keni
10 thënë ZPS-së që shkuat për të kërkuar Sokol Dobrunën, por në
11 vend që të gjeni Sokol Dobrunën gjetët Rexhep Selimin. A është
12 e saktë kjo? Këtë ia keni thënë ZPS-së në faqen, në provën
13 P2007.4, në Pjesën 4 të intervistës tuaj në faqen 12. A është
14 e saktë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Jo.

16 PY. Nuk e gjetët Rexhep Selimin? Nuk u takuat me Rexhep
17 Selimin?

18 PË. Unë nuk e kam kërkuar Rexhep Selimin, dhe nuk e kam
19 takuar Rexhep Selimin. E kam kërkuar Sokol Dobrunën. Nuk e kam
20 gjetur. Dhe ka mundësi ta kemi takuar z. Kryeziu, apo një
21 tjetër, por nuk mendoj se e kam takuar Rexhep Selimin në
22 Shtabin e Përgjithshëm në lidhje me çështjen.

23 PY. Ju me të jeni takuar vetëm një herë lidhur me këtë rast,
24 apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Lidhur me këtë rast, jemi takuar vetëm një herë, atë qysh

1 e kam sqaruar, me rastin e ballafaqimit me personat e ndaluar.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
3 paraqesë në ekran provën P2019, që është shënimi me shkrim
4 dore të cilin jua treguan dje nga Prokuroria.

5 PY. E shikoni dokumentin në ekran, z. Krasniqi?

6 PË. Po, e shikoj.

7 PY. Në cep, në të majtë të dokumentit me shkrim dore, thuhet
8 "Divjakë, 1 maj 1999". Kjo ka qenë data e takimit që keni
9 pasur ju me z. Selimi, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Mund të jetë kjo data, mund të jetë, por nuk mund të jem
11 i saktë lidhur me datën e takimit. Sidoqoftë, nëse mund të
12 shtoj, takimi ka ndodhur ditën kur të ndaluarit janë liruar,
13 do të thotë, në qoftë se dihet në bazë të shkresave të lëndës
14 se në cilën datë janë liruar të ndaluarit, atëherë ajo ka qenë
15 dita e takimit.

16 PY. Ky dokument i referohet Divjakës, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Ashtu po shkruan në këtë dokument --

18 PY. -- [Mikrofoni çaktivizuar] Kleçkës.

19 PË. -- se unë e kam ende të qartë autorësinë e këtij
20 dokumenti. Sepse do të më ndihmonte sikur ta dija autorësinë.

21 PY. Kjo supozon se nëse ky është dokument i shkruar nga z.
22 Selimi, i takon që ky takim të jetë zhvilluar në Divjakë, a
23 është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Unë mund të dëshmoj këtu se ku ka ndodhur takimi, e jo se
25 çka shkruan në dokumentin. Nëse shohim dokumentin, është e

1 saktë se këtu shkruan "Divjakë". Tash, unë nuk e di kush e ka
2 shkruar dokumentin dhe kur e ka shkruar dokumentin. Unë mund
3 ta paraqes vetëm të vërtetën time. Mirëpo, ju që i referoheni
4 dokumentit është e saktë që shkruan "Divjakë".

5 PY. Ju nuk e dini arsyen se pse z. Selimi ka ardhur për t'ju
6 takuar ju, ose kush i kishte kërkuar atij këtë gjë, këtë ia
7 keni thënë ZPS-së në provën gjyqësore P2007.4, faqja 13, deri
8 në 14. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Arsyeya e takimit e ardhjes të z. Selimi ka qenë
10 ballafaqimi me të ndaluarit për ta sqaruar ose për t'i sqaruar
11 rrethanat se mbi çfarë baze janë ndaluar të lartpërmendurit,
12 ose ata që u përmendën pak më herët.

13 PY. Në rregull. A keni qenë të informuar në atë kohë,
14 domethënë, nga fundi i prillit, fillimi i majit, që Shtabi i
15 Përgjithshëm ka qenë i stacionuar jashtë Divjakës, në zonën e
16 Nerodimës?

17 PË. Unë e kam thënë edhe më herët, që Shtabi i Përgjithshëm
18 sikurse edhe njësitë apo nivelet e tjera, për shkak të
19 rrethanave kanë lëvizur gjatë luftës, mirëpo selia e Shtabit
20 të Përgjithshëm ka qenë në Divjakë. Ka qenë në Divjakë. Kështu
21 që në periudhën që po i referohemi, nuk e di se sa nga
22 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm dhe cilët, mirëpo disa prej
23 tyre kanë qenë në Divjakë duke përfshirë edhe z. Selimi.

24 PY. Z. Selimi ka qenë një prej personave të vetëm që ka
25 mbetur aty, apo jo? A është në përputhje me çfarë ju kujtohet

1 juve për atë kohë, Dëshmitar? Domethënë, ai ka qenë personi i
2 vetëm që ka mbetur në Divjakë në atë kohë, që ka qenë në
3 Divjakë në atë kohë, është kështu apo jo?

4 PË. Tash, nuk mund ta di me saktësi se kush ka mbetur aty,
5 mirëpo së paku bazuar në takimet i cili ka ndodhur, z. Selimi
6 ka mbetur aty. Po kush tjetër, nuk mund të jem i saktë.

7 PY. Sapo na thatë përpara një çasti që kur z. Selimi ka qenë
8 aty, arsyeja për mbërritjen e tij ishte që të sqaronte bazën e
9 ndalimit të këtyre pesë personave.

10 I keni thënë ZPS-së se ju besonit që ju konsideronte juve
11 dhe Osman Hoxhën që të ishit mundësisht ose potencialisht
12 subjektiv lidhur me këtë rast, apo jo?

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal këtë e keni thënë
14 në faqen 13 të provës P2007.4.

15 DËSHMITARI: Për të qenë i saktë, kjo mendoj që është
16 marrë vetëm me mua, por jo edhe Osman Hoxhën, sepse rastin ma
17 ka, më është atribuar mua. Në fund të fundit, pavarësisht që
18 në rastet e intervistimeve kam pas përkrahjen dhe ndihmën e z.
19 Osman Hoxha, kryesisht me çështjen jam marrë unë.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim]

21 PY. Por, shqetësimi im -- dhe do lexoj këtu atë çfarë keni
22 thënë ju. Ju thoni:

23 "... unë së bashku me Osman Hoxhën kemi qenë të
24 pranishëm, mund të ketë ndodhur që të ketë qenë ndonjë person
25 tjetër, por nuk më kujtohet. Ai më pyeti lidhur me faktet ku i

1 kishim bazuar ...”

2 Ju kërkoj ndjesë se po lexoj citimin e gabuar. Ndjesë,
3 dhe një herë. Përpara kësaj pjese që sapo lexova, ju thoni si
4 më poshtë:

5 “Z. Selimi po mendonte që ne mund të ishim subjektivë
6 ...”

7 Këtë i keni thënë ZPS-së. Ishte citim nga deklarata juaj.
8 A e mendoni këtë si shqetësimin e tij, domethënë që ky ishte
9 shqetësimi i tij, Dëshmitar?

10 PË. Kjo mendoj është, ka qenë mendimi im, dhe është
11 supozuese, në fund të fundit nuk di se çfarë ka menduar z.
12 Selimi. Por nga vetë fakti i ardhjes së tij, i ballafaqimit
13 dhe i pyetjes së tij se mbi cilën bazë janë ndaluar personat,
14 kur unë ia kam vendos dosjen e tyre që kisha përgatitur para
15 tij, nënkupton se përderisa e ka kërku bazën e ndalimit të
16 tyre, atëherë mbi këtë bazë e kam mbështet pohimin tim.

17 PY. Në rregull. Në seancën përgatitore keni deklaruar jo
18 vetëm aty, por edhe në dokumentet që i pamë dje, që një prej
19 ankimuesve në këtë rast ka qenë Faik Shala. Keni thënë që Faik
20 Shala vinte nga një fshat aty afër? Çak [fonetikiisht]?

21 PË. Po, nga fshati Ngucat.

22 PY. Urdhri që u diskutua dje, që kërkonte që personat e
23 dyshuar të raportonin në Kleçkë, kishin të bënin konkretisht
24 me individët të cilët kanë qenë të përfshirë në rrahjen e Faik
25 Shalës.

- 1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Më konkretisht kjo është e
2 reflektuar në provën P2010 në faqen 083059.
3 PY. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?
4 PË. Jo vetëm për rastin e Faik Shalës, por për të gjitha
5 rastet që janë në shënime dhe në ato shënime të tjera të cilat
6 nuk i posedojmë.
7 PY. Por, nga informacioni që kemi ne, ju besoj që pajtoheni
8 që ky incident me Faik Shalën ka qenë faktori kryesor për
9 ndalimin dhe arrestimin e këtyre personave. A pajtoheni me
10 mua, lidhur me këtë, Dëshmitar?
11 PË. Nuk mund të them vetëm i Faik Shalës. Për rastet
12 paraprakisht janë grumbulluar dhe pasi janë siguruar shumë
13 dëshmi, personat janë ndaluar. Do të thotë, tash unë nuk mund
14 të them se cili rast mund të ketë qenë vendimtar. Njëri nga
15 rastet bukur të rënda ka qenë i Faik Shalës. Mirëpo, tash nuk
16 mund t'i, t'ua jap peshën veç e veç rasteve sepse edhe ka
17 kaluar shumë kohë. Mirëpo, të gjitha rastet së bashku kanë
18 sjellë deri te një vendim apo veprim i tillë i cili u ndërмор.
19 PY. Ju thoni që Faik Shala ka qenë një ndër kryesorët. A ka
20 pasur ndonjë marrëdhënie familjare ai me Haxhi Shalën, në
21 qoftë se ju kujtohet? Domethënë, a është i lidhur me gjakun,
22 me Haxhi Shalën, ka lidhje familjare me Haxhi Shalën, me
23 komandantin e brigadës tuaj?
24 PË. Edhe një herë dua të potencoj që nuk do të thotë që
25 rastet të tjera kanë qenë më të vogla se ai i Faik Shalës.

1 Mirëpo, ai i Faik Shalës ndoshta është në fillim të lëndës
2 aty, bie në sy më shumë. Ka pas edhe raste të tjera dhe
3 ndoshta hiç ma pak ma të lehta se i Faik Shalës. Ndërsa sa i
4 përket lidhjes së Faik Shalës me z. Haxhi Shala, nëse ishte
5 pyetja kështu, unë nuk di që kanë pas ndonjë lidhshmëri
6 familjare. Së paku unë nuk jam në dijeni për një lidhshmëri të
7 tillë.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
9 paraqesë në ekran provën P2010, me numër ERN-je 1082191 [Sipas
10 përkthimit] deri në 083087 në faqen 083069.

11 PY. Është deklaratë që është marrë nga dosja e lëndës së --
12 nga Azem Olluri. Na prisni pak çaste, ju lutem, Dëshmitar.

13 Është një deklaratë e Azem Ollurit, njëri prej personave
14 të përfshirë. Dhe diku nga dy të tretat e faqes, ose të
15 intervistës ai flet lidhur me rastin, me incidentin në fjalë,
16 Faik Shalën, do t'jua lexoj. Pra, aty thuhet:

17 "... më thanë që pse nuk erdhën atëherë kur ju thamë që
18 të vinit". Pra, "Sylë Qirriqi ia bëri këtë pyetje dhe më pas
19 'Ju dhe pse nuk jeni ardhur këtu, atëherë ju na keni drejtu pa
20 kurrfarë arsyeje, dhe nuk ju ka interesu fare kjo punë, ti ia
21 ke nisur kësaj pune'. Sylja i tha se 'nuk ke punë në këtë, por
22 unë të pyeta kurse ai tha që as nuk kam punë as me Haxhinë
23 ...'" e të tjera, e të tjera.

24 Dëshmitar, a ju kujtohet kjo, a mund ta gjenit këtë
25 pjesën te versionin në shqip dhe ta lexonit vetë?

1 PË. Po, e gjeta këtë pjesë. Mirëpo, këtë nuk mund ta kujtoj
2 absolutisht në mënyrë specifike, sepse dhe intervistimin nuk e
3 kam bërë unë të këtij personi. Thjesht po e shof, po e lexoj,
4 por nuk mund ta kujtoj, nuk kam mundur ta kujtoj deri tash
5 përmendsh këtë element.

6 PY. Atëherë, unë ju sugjeroj që duke u mbështetur në këtë
7 dëshmi nga Azem Olluri, mënyrën se si e kujton ai këtë rast,
8 këtë incident me Faik Shalën, i takon që Faik Shala po i
9 kërkon që të mbështeten në lidhjen që ai kishte me Haxhi
10 Shalën lidhur me këtë debat, ose mosmarrëveshje. A ka ndonjë
11 arsye që ju ta vini në dyshim këtë mënyrë të të kuptuarit?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtojmë, është spekulim,
13 hamendësim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
15 Përgjigjuni, Dëshmitar.

16 DËSHMITARI: Krejt çfarë mund të them unë është sepse puna
17 jonë është bazuar në fakte dhe prova konkrete, dhe absolutisht
18 kjo fjali nuk na ka çuar peshë neve dhe sot e kësaj dite, nuk
19 kam asnjë fakt, asnjë të dhënë që ky person ka pasur ndonjë
20 lidhshmëri me z. Shala. Për më tepër - me z. Haxhi Shala - për
21 më tepër, sepse Faik Shala është i fshatit Ngucat, ndërsa
22 Haxhi Shala është nga fshati Banjë i Malishevës.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim]

24 PY. Tani le të kalojmë te fushëveprimi i rastit. I keni thënë
25 ZPS-së që bëhej fjalë për një rast goxha i madh, dhe që kishte

1 përfshirë apo kishte marrë interesin e Shtabit të
2 Përgjithshëm, dhe mund të kishte një ndikim edhe mbi UÇK-në.
3 Kam përshtypjen që diçka të tillë e thatë dje.

4 Tani në qoftë se do t'i kthehemi përsëri shënimeve me
5 shkrim dore, këtij shënimi që pamë pak më përpara --

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kështu që për këtë do t'i kërkoja
7 Sekretares të kalojmë përsëri te prova 02019.

8 PY. Një ndër problemet që duket sikur shfaqet aty është që
9 policia ushtarake nuk u raporton organeve më të larta dhe po
10 vepronte në mënyrë të pavarur. A ju kujtohet t'i keni thënë z.
11 Selimi për, t'i keni treguar z. Selimi këto lloj problemesh,
12 Dëshmitar?

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Atëherë, Sekretares i kërkoj që të
14 kalojmë te faqja e parë e këtij dokumenti.

15 PY. Ndoshta katër pesë rreshta më poshtë, ku flitet për
16 pavarësinë e vendimeve dhe mosraportimin tek organet më të
17 larta. A ju kujtohet ta keni diskutuar këtë me z. Selimi,
18 Dëshmitar?

19 PË. Me z. Selimi është diskutuar përmbajtja e ecurisë së atij
20 rasti. Tash, bazuar në këto shtylla të këtij shënimi të cilat
21 i kam para vetes këtu, korrespondojnë me rastin, përkatësisht
22 me një bisedë ose një përmbledhje të mundshme të atij rasti.

23 PY. Në rregull. Pra, ju e pranoni se ka pasur probleme lidhur
24 me këta pesë persona që nuk i raportonin organeve më të larta.
25 A është fakt ky? Ju lutem, përgjigjuni me "po" ose "jo" nëse

1 mundeni.

2 PË. Problemet të cilat ata i kanë shkaktuar, nuk ka qenë
3 perceptim as i imi dhe as i ekipit tim, por kanë qenë ankesa
4 të qytetarëve dhe të ushtarëve. Prandaj, aty bazohen ankesat.

5 PY. Të kalojmë dy faqe më poshtë. Më konkretisht është faqja
6 SPOE00226485, që duket sikur janë shënime që janë marrë pas
7 bisedës me z. Krasniqi, komandant i PU-së së ZOP-së. Që është
8 Nexhmi Krasniqi, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Nexhmi Krasniqi ka qenë në atë periudhë komandanti i PU-
10 së në zonën operative të Pashtrikut, kjo është e saktë.

11 PY. Përsëri, këtu ka çështje të renditura. Domethënë, thuhet
12 që personat nuk kanë qenë në zinxhirin e komandës, ose në
13 komandën e hierarkisë, nuk kanë respektuar komandën më të
14 lartë, e të tjera. Siç mund ta lexoni aty. A është kjo në
15 përputhje me atë se si e keni kuptuar ju informacionin që ka
16 të bëjë me këtë rast, ose provat ose të dhëna që kanë të bëjnë
17 me këtë rast, të mbledhura prej jush?

18 PË. Qysh e thashë, këto shënime të kam para vetes,
19 korrespondojnë me përmbajtjen e shkeljeve ose lëndës lidhur me
20 rastin.

21 PY. Përsëri, në faqen tjetër thuhet e njëjta gjë. Domethënë,
22 thuhet e njëjta gjë edhe sa i takon Avni Shalës, pra thuhet
23 komandanti i skuadrës së dytë të PU-së së Brigadës 121, Avni
24 Shala dhe këtu thuhet që "këto persona nuk më raportojnë mua",
25 domethënë, personi ankohet sa i takon mungesës së raportimit

1 prej tyre. Dhe thuhet që "ka pasur edhe raste kur ata kanë
2 vepruar pa urdhra".

3 E shikoni këtë dokument, Dëshmitar?

4 PË. Po, e shikoj, vetëm se dokumenti nuk përmban datë, se në
5 çfarë date është shënuar ose është mbajtur ky shënim.

6 PY. Sigurisht. A ka pasur fraksione, mosmarrëveshje, brenda
7 Brigadës 121 sepse kishte persona që nuk e njihnin Haxhi
8 Shalën si komandant, nuk e pranonin Haxhi Shalën si komandant
9 brigade? Përçarje, pra, brenda brigadës.

10 PË. Nuk e di. Atë që mund të them se në komandën e Brigadës
11 121 nuk ka pas fraksione, nuk ka pas përçarje, këtë mund ta
12 them me përgjegjësi. Për më tutje, nuk mund ta them.

13 PY. Po këta katër pesë persona, këta katër pesë oficerë të
14 policisë ushtarake, a nuk ishin -- a nuk ishin pjesë e grupit
15 që nuk e njihnin Haxhi Shalën si komandant brigade?

16 PË. Nuk mendoj ashtu. Nuk ndaj të njëjtin mendim.

17 PY. Në këtë dokument, ju lutem, të shkojmë në faqen 6484, më
18 duket se është dy faqe mbrapa. Që besoj se janë shënime të
19 asaj që ka thënë Haxhi Shala:

20 "- Po i referohem --

21 "- Kam kontribuar t'i tejkalojmë mosmarrëveshjet, por pa
22 sukses.

23 "- Ju kam tërhequr vëmendjen për këtë çështje."

24 Pra, a e kuptojmë drejt ne sipas këtyre shënimeve që
25 Haxhi Shala është përpjekur të marrë disa masa disiplinore për

1 këta persona por nuk ia ka dalë dot mbanë?

2 PË. Mosdisiplina e ushtarëve në fjalë ose shkeljet e
3 ushtarëve në fjalë, nuk kanë pas të bëjnë për atë se iu pëlqen
4 apo s'iu pëlqen Haxhi Shala apo e njohin apo s'e njohin Haxhi
5 Shalën për komandant. Ata thjesht kanë rënë në kundërshtim me
6 rregullat e brendshme të UÇK-së, apo me normat njerëzore.

7 PY. Por ai thotë këtu "pa sukses", pra vetë z. Shala e ka
8 pranuar që nuk e ka zgjidhur dot situatën, apo jo?

9 PË. Kur personat janë disa herë shkelës për shkelje të
10 njëjta, atëherë ata janë recidivista. Do të thotë, kjo ndodh
11 jo vetëm në rrethana lufte por edhe në kohë paqeje mund të
12 ndodhin gjëra të tilla.

13 PY. Më falni, Dëshmitar -- më falni që ju ndërpreva, por ju
14 lutem, thjesht përgjigjuni pyetjes. Pyetja ishte, çfarë keni,
15 thuhet në shënim, për pozicionin e Haxhi Shalës? Sipas këtij
16 shënimi ai vetë e ka pranuar që nuk ka qenë në gjendje ta
17 zgjidhë situatën. A është ky një vlerësim i drejtë?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E kundërshtoj.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzoj
20 kundërshtimin e Prokurorisë.

21 Dëshmitar, mund t'i përgjigjeni.

22 DËSHMITARI: Nuk e di, për këtë duhet pyetur z. Haxhi
23 Shala.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim]

25 PY. Në rregull. Unë po përpiqem të them këtë: në këto

1 rrethana, në këtë situatë, a e pranoni ju që ka qenë një
2 person i jashtëm si z. Selimi, pra një person i jashtëm si z.
3 Selimi, thjesht është përpjekur të ketë qenë ndërmjetës në
4 këtë situatë, që t'i zgjidhte këto problematika që kishit në
5 varësi, në këtë hierarki?

6 PË. Se a ka mundur të jetë ndërmjetës z. Selimi në mes të
7 Haxhi Shalës dhe personave në fjalë apo personave të tjerë,
8 unë këtë pjesë nuk e di. Krejt atë që e di dhe mund ta them,
9 është me rastin e ballafaqimit me personat e ndaluar dhe
10 lirim të tyre. Kaq mund të them unë.

11 PY. Në rregull. Ju e keni bërë shumë të qartë kur thatë që z.
12 Dobruna nuk ka qenë i disponueshëm kur shkuat ju me këta
13 persona. A e kam kuptuar drejt unë që ju nuk e dinit as ku
14 ishte dhe as sa kohë kishte që kishte ikur?

15 PË. E saktë.

16 PY. Dhe sikurse e thatë edhe dje, nuk kishte ndonjë gjykatës
17 tjetër sepse z. Dobruna nuk emëroi ndonjë Gjykatës tjetër për
18 Gjykatën ushtarake, saktë?

19 PË. E saktë.

20 PY. Dhe në seancën përgatitore, ju i keni thënë Prokurorisë
21 në provën P2009, ju keni thënë që kur erdhi fillimisht z.
22 Selimi, ju përgëzoi për punën që kishit bërë me këtë çështje,
23 me këtë rast, saktë?

24 PË. Po, e saktë. Kjo ka ndodhur -- më fal, nëse mund ta
25 vazhdoj, kjo ka ndodhur me rastin kur ia kam vendosur para

1 vetes dosjen e personave të ndaluar, e cila ishte mjaft
2 voluminoze, ka filluar t'i shfletojë disa fletë sipërfaqësore,
3 dhe në pamundësi që t'i lexojë të gjitha sepse do të merrnin
4 kohë, atëherë më ka përgëzuar dhe më ka thënë se "A mund t'i
5 merr me vete për rreth një javë", në mënyrë që t'i lexojë
6 gradualisht dhe më pas të m'i kthejë të njëjtat.

7 PY. Po, ka qenë kërkesë prej tij, një kërkesë prej tij që ju
8 t'i jepnit dosje, nuk ishte urdhër, apo jo, ishte thjesht një
9 kërkesë?

10 PË. Çështja e funksionimit të strukturës së UÇK-së nuk ishte
11 vetëm çështje formale, por ishte edhe çështje besimi në të.
12 Ishte çështje e ndërgjegjshmërisë së vetë personit, në këtë
13 rast e imja. Do të thotë, personi i përgjegjshëm dhe personi
14 që ka pasur besim në strukturë, edhe e ka respektuar,
15 pavarësisht se si mund të quhet urdhën apo kërkesë. Ai ma
16 kërkoi në mënyrë të sjellshme, me mirësjellje. Kjo është e
17 vërtetë. Mirëpo, kushdo që do ma kishte kërkuar dosjen, do
18 t'ua kisha dhënë në sajë të përgjegjshmërisë së ime dhe në
19 sajë të besimit tim në atë strukturë.

20 PY. Po. Kur keni folur për ballafaqim në shënimin përgatitor,
21 kjo në fakt nuk përputhet me tonin që ka përdorur z. Selimi,
22 nuk ka qenë ky diskutimi me z. Selimi, s'ka qenë ballafaqim,
23 apo jo?

24 PË. Po ballafaqim përderisa mue më është dashur t'i nxjerr në
25 diskutim arsyet, bazën për ndalesën e personave, shkeljet e

1 tyre dhe qëllimin që i kemi ndalu dhe më pastaj u është dhënë
2 dikujt prej tyre fjala dhe ata e kanë paraqit veten e tyre se
3 janë të pafajshëm. Do të thotë, ata kanë diskutu gjithashtu se
4 janë të pafajshëm.

5 PY. Po. Por unë desha të thoja këtë, nuk ka qenë ndonjë
6 situatë agresive, nuk ka pasur ndonjë ton agresiv, nuk ka pas
7 ndonjë ton ballafaques. Thjesht është kërkuar informacion se
8 si po shkonte rasti nga z. Selimi, apo jo?

9 PË. Asnjëherë, në asnjë bisedë me asnjë nuk mbaj të jetë bërë
10 në mënyrë agresive.

11 PY. Thatë që ishte një dosje e detajuar, dhe ai e mori që ta
12 lexonte për një javë për shkak të vëllimit të informacionit në
13 të, apo jo?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. A e kam kuptuar unë drejt që ju nuk i kërkuat z. Selimi
16 t'ia dorëzonte dosjen e këtij rasti z. Dobruna, megjë vetë z.
17 Dobruna nuk ishte atje?

18 PË. Asnjë lloj kërkesë nuk i kam bërë unë z. Selimi për
19 asgjë, në lidhje me asgjë.

20 Por, ajo çfarë dua të shtoj, nëse mundem, Trup Gjykues,
21 unë e vlerësoj lart z. Selimi për kontributin e tij dhënë për
22 lirinë dhe shtetësinë e Kosovës. Në kontekstin e rrethanave të
23 kohës, z. Selimi mund të ketë bërë veprimin e duhur që i ka
24 liruar të ndaluarit. Unë nuk jam këtu për ta vlerësuar një gjë
25 të tillë. Unë jam këtu për të dëshmuar me korrektësi për atë

1 që kam parë dhe që kam dëgjuar, ose thjesht që e di.

2 Përgjegjshmëria ime është që të dëshmoj qartazi, në mënyrë të
3 saktë, atë që ka ndodhur, por jo që të jap vlerësime për
4 veprimet.

5 Edhe një herë po e përsëris. Ai mund të ketë bërë
6 veprimin e duhur sepse ne kemi qenë ata që i kemi ndaluar
7 personat, dhe jo z. Selimi. Z. Selimi i ka liruar ata persona,
8 kaq.

9 PY. Po. Kur thoni ka liruar, a ka pasur ndonjë vendim me
10 shkrim për lirimin e tyre?

11 PË. Jo. Jo, ajo krejt çka ka ndodhur në fund të atij takimi
12 ka ndodhur në mënyrë verbale. Do të thotë, lirimi i tyre ka
13 ndodhur në mënyrë verbale. Këta duhet të lirohen dhe stafi i
14 qendrës së mbajtjes i ka liruar. Kaq.

15 PY. E kam kuptuar unë drejt që ju nuk e keni kundërshtuar
16 kërkesën për lirimin e tyre?

17 PË. Jo vetëm në këtë rast, por në asnjë rast të vetëm unë nuk
18 e kam kundërshtuar asnjë lirim sepse as që më ka interesuar.
19 Dhe këtë rast e di kur është liruar sepse kjo ka ndodhur në
20 praninë tonë që kemi qenë në atë takim, ndërsa në raste të
21 tjera, as nuk e di kur mund të jenë liruar personat e ndaluar
22 sepse nuk ka qenë çështje në kuadër të kompetencave të mia. Do
23 të thotë, nuk ka qenë detyrë e imja të kundërshtoj.

24 Dhe nuk mendoj që është rregull të kundërshtojë dikush që
25 është më poshtë ta kundërshtojë dikënd që është pak më lart,

1 ose më lart. Sepse në fund të fundit, në kontekst të
2 rrethanave, e thashë edhe më herët, unë kam menduar që po bën
3 gjënë e duhur, po bën veprimin e duhur.

4 PY. Pse mendoni ju ose pse mendonit në atë kohë që ai po
5 bënte gjënë e duhur?

6 PË. Sikurse dhe në raste të tjera, sikurse edhe rastin kur
7 Agim Çeku e ka dënuar një ushtar të ndaluar me 25 ditë burg,
8 sikurse dhe raste të tjera, pavarësisht se çka është vendosur,
9 si rasti i Blerim Kuqit që është ndalu dhe është liru, kanë
10 qenë çështje e mekanizmave të tjerë. Do të thotë, kam qenë
11 personalitet i tillë që nuk kam kundërshtuar asnjë lloj
12 vendimi apo detyre apo urdhri apo kërkesë e dikujt apo e atyre
13 ma lart.

14 PY. Dje thatë që nuk ka pasur ndonjë rregullore apo ndonjë
15 procedurë se si do veprohej me këto raste kur nuk ishte i
16 pranishëm z. Dobruna, apo jo?

17 Kjo është thënë në transkriptin e ditës së djeshme,
18 transkriptin provizor. Pra, ju keni thënë që:

19 "Nuk ka pasur ndonjë procedurë standarde, ndonjë
20 praktikë", më saktë, thatë ju, "edhe nuk ishte e mundshme të
21 kishim një praktikë", apo jo?

22 PË. Unë e kam thënë disa herë se nuk kemi pasur procedura të
23 listuara të shkruara, se si duhet të veprohet me këto raste,
24 përveç udhëzimeve që kam pranuar nga z. Dobruna.

25 PY. Po. Dhe kur nuk ishte i pranishëm z. Dobruna, nuk kishte

1 as procedura me shkrim, dhe ju nuk mund të thoni ose të paktën
2 nuk mund të thoni me siguri, se z. Selimi e dinte se çfarë
3 procedure duhej ndjekur në atë rast?

4 PË. Nuk e di.

5 PY. Vazhdojmë. Dje thatë se ky rast, kjo çështje u mbyll, kur
6 u liruan të dyshuarit. Por, në mungesë të z. Dobruna, në fakt
7 në thelb nuk pati asnjë çështje. Ju thjesht nuk kishit më
8 dosjen e këtij raste sepse dosjen e rastit e kishte z. Selimi,
9 apo jo?

10 PË. Kjo çështje për mua për ekipin tim u mbyll si çështje
11 penale. Do të thotë, ne pretendonim se kishte shkelje penale,
12 do të thotë, dyshime për vepra penale. Dhe u mbyll në kuptimin
13 e çështjes penale, ndërsa vazhdoi me brigadën si çështje
14 disiplinore.

15 PY. Po. Do ta riformuloj dhe një herë pyetjen. Z. Dobruna
16 qartazi nuk ka qenë i përfshirë në këtë vendim, këtë e keni
17 konfirmuar tashmë. Dhe dosjen ju ia kaluat z. Selimi, dosjen e
18 kësaj çështjeje. Por, ju nuk mund ta thoni me siguri që kjo
19 çështje u mbyll. Thjesht ju vetë nuk e kishit më dosjen e
20 këtij rasti në duart tuaja. Po ose jo, nëse mundesh. Por nëse
21 gjykon që duhet të thuash diçka më shumë, ju lutem
22 shtjellojeni.

23 PË. Si për këtë rast, si për raste të tjera, kur kam thanë
24 dhe kur them u mbyll, u mbyll për mua, u mbyll për ne. Unë nuk
25 e di nëse ka vazhduar më tutje, siç ju pretendoni apo është

1 dashur të vazhdojë. Ka qenë pjesë tjetër që nuk e di dhe nuk
2 më ka interesuar ta di.

3 PY. Këtë në fakt, këtë doja të thoja dhe unë. Ai nuk është
4 takuar -- më fal, ju nuk jeni takuar me z. Selimi pas kësaj
5 date për të diskutuar ndonjë detaj lidhur me rastin, këtë e
6 keni konfirmuar në Shënimin Përgatitor 2, paragrafi 96, saktë?
7 PË. Nuk ka qenë praktikë e imja të kontaktoj për një rast i
8 cili për mua ka përfunduar, asnjëherë. As në këtë rast dhe as
9 në raste të tjera.

10 PY. Pra, ju nuk folët me z. Selimi pas kësaj, dhe me sa ju
11 kujtohet ju, as me z. Dobruna nuk keni diskutuar për këtë rast
12 më pas, apo jo?

13 PË. Me z. Dobruna mund ta kem biseduar si në formë të asaj që
14 e kam kërkuar, nuk e kam gjet, në lidhje me diçka, por jo
15 konkretisht. Jo në kuptimin formal. Dhe me z. Selimi asesi nuk
16 e kam diskutuar, asnjëherë tjetër.

17 PY. Pra, sidoqoftë, ju nuk mund ta përjashtoni mundësinë që
18 dosja përfundimisht t'i ketë kaluar z. Dobruna. Ju thjesht nuk
19 e dini se çfarë ka ndodhur me këtë dosje që e dorëzuat.

20 PË. E saktë.

21 PY. Lidhur me një çështje tjetër, z. Dobruna ju ka thënë
22 gjatë luftës se nuk kishin kushte në atë kohë për gjykime dhe
23 për të dhënë dënime, dhe se ai do të përpiqej t'i gjykonte
24 këto raste në një gjykatë të rregullt normale pas luftës. Pra,
25 z. Dobruna e kishte për qëllim që pas luftës të gjykoheshin

1 çështjet, apo jo?

2 PË. Po, ka thënë se pas luftës këto çështje do t'u kalohen
3 gjykatave të rregullta.

4 PY. Por lidhur me një çështje kur e pyetët ju pse nuk
5 vazhduat me këtë çështje, ai t'u përgjigj edhe tha, "s'kam
6 arkivën e gjykatës ushtarake". A ju kujtohet t'ia keni thënë
7 këtë ZPS-së?

8 PË. Kjo ka ndodhur pas luftës, jo gjatë luftës.

9 PY. Por sidoqoftë, ju nuk mund ta përjashtoni mundësinë që
10 dosja t'i ketë kaluar z. Dobruna dhe z. Dobruna të ketë
11 vendosur që këtë rast ta trajtojë pas luftës.

12 PË. Sigurisht, nuk e përjashtoj atë mundësi. Thjesht, nuk e
13 di.

14 PY. E kuptueshme. Sipas dëshmisë suaj, ju keni thënë që pasi
15 u liruan këta persona, ju i raportuat Haxhi Shalës, i cili
16 vendosi t'u hiqte statusin e policëve ushtarakë. Mund të
17 përgjigjeni me, thjesht me "po" nëse mjafton.

18 PË. Jo vetëm që raportuam, por edhe i kërkuam që t'ua hjekë
19 statusin e policit ushtarak.

20 PY. Po. Ai e bëri këtë dhe pas kësaj bëri një njoftim publik
21 të këtij vendimit, ku shpjegonte se ishin marrë masa
22 disiplinore për t'i liruar nga detyra këta persona. Pasi ishin
23 liruar, është marrë ky vendim, apo jo?

24 PË. Janë liruar nga policia ushtarake dhe janë transferuar në
25 pika të ndryshme si ushtarë të rregullt.

1 PY. Dje në dëshminë tuaj, ju thatë që nuk e trajtonit, nuk e
2 trajtuat më këtë si çështje penale kur u liruan personat, por
3 filluat, u trajtua si një çështje disiplinore. A ju kujtohet
4 ta keni thënë këtë dje në Gjykatë?

5 PË. Po. Vendimet që janë marrë në lidhje me personat në fjalë
6 janë marrë në kuadër të kompetencave të rregullores së
7 brendshme për shkelje disiplinore.

8 PY. Dhe kjo në fakt është e ndryshme nga ajo që keni thënë në
9 shënimin përgatitor në paragrafin 101, ku keni thënë se nëse
10 kur ju pyetën nëse do të vazhdonit ta hetonit rastin pasi u
11 liruan të dyshuarit, ju thatë që jo, sepse rasti, çështjen e
12 kishte tashmë Rexhep Selimi, i cili ishte pjesë e Shtabit të
13 Përgjithshëm.

14 PË. Po çështjen e kishte, e kishte dosjen. Ai e kishte
15 dosjen, dhe thjesht nuk më ka interesu ma për rrjedhën e
16 mëtutjeshme në kuptimin e dyshimeve penale. Për mu ishte
17 çështje e mbyllur, pavarësisht nëse janë marrë veprime nga
18 instanca të tjera apo jo.

19 PY. Por ju vazhduat të hetonit për këta katër apo pesë
20 persona, apo jo?

21 PË. Nuk kemi vazhduar t'i hetonim, absolutisht, asnjë
22 deklaratë shtesë nuk është marrë pas kësaj periudhe. Çdo herë
23 duke u bazuar në shkeljet e njëjta.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shohim provën më mirë. Ju lutem të
25 shohim provën P2010 në faqen 083070. Faqja 81 në versionin në

1 PDF.

2 PY. Presim të dalë edhe shqipja.

3 Në shqip, Faik Shala, data është 2 maj 1999. Pra, pasi
4 ishin liruar personat, saktë?

5 PË. Kush e ka nënshkruar këtë dokument, të lutem? Se nuk po e
6 shoh nënshkrimin.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shkojmë në fund, mbase është në
8 faqen tjetër. Në fund, ju lutem.

9 PY. E njihni nënshkrimin në të majtë?

10 PË. Po. Po, e njoh nënshkrimin. Është i z. Osman Hoxha. A
11 mund të kthehemi në fillim të faqes?

12 PY. Patjetër. Patjetër.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kthehemi në fillim të faqes.

14 PY. Data këtu është 2 maj 1999, që i takon pas datës kur
15 është vendosur të lirohen këta persona. Çka do të thotë që
16 hetimet kanë vazhduar dhe më pas.

17 PË. Këtë saktë duhet ta thotë z. Osman Hoxha, apo është
18 çështje e numrit të protokollimit, si e ka shënuar me vonesë
19 apo gabimisht. Mirëpo, nuk ka pas vazhdim të hetimeve pas
20 këtij rasti, përveç nëse ka pasur shkelje të reja. Po flas për
21 ato që i di unë. Tash jo gjithçka mund ta di personalisht.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shohim faqen 083074.

23 PY. Është një deklaratë tjetër kjo, lidhur me këto hetime.

24 Shihe datën lart, ju lutem, në të majtë. Këtu është data 6 maj
25 1999. Në krye të faqes në të majtë, e shihni?

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts (Vazhdim)

Faqe 28

1 PË. Po. Mundësisht ta shoh edhe nënshkrimin edhe në këtë
2 rast.

3 PY. Sigurisht.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shkojmë në fund.

5 PY. E njihni nënshkrimin në fund, në fund të këtij dokumenti?

6 PË. E njoh, nuk është nënshkrimi im.

7 PY. Mirë. Shkojnë në krye të dokumentit në të majtë, dhe në
8 anglisht dhe në shqip. Është policia ushtarake ajo që i ka
9 kryer hetimet. Pra, unë siç po e kuptoj unë, është që ju
10 personalisht nuk keni kryer më hetime për këtë rast. A e
11 kuptoj saktë unë?

12 PË. Unë, dhe Brigada 121 mendoj që nuk kanë kry. Unë
13 personalisht jo se jo, por nuk jam në dijeni edhe të brigadës
14 të ketë kryer hetime të mëtejme.

15 PY. Po as e keni parë ju dokumentin e Osman Hoxhës, se Osman
16 Hoxha ka qenë në brigadën tuaj dhe sipas dokumentit kanë
17 vazhduar hetimet edhe pas lirimit të këtyre personave?

18 PË. Për këtë mendoj se duhet të pyetet z. Osman Hoxha më
19 saktë.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shohim një dokument tjetër. Është
21 një dokument që është pjesë e të njëjtit grup dokumentesh, por
22 nuk është pranuar si provë. Është pjesë e numrit 082926,
23 083087. Dhe ne duhet të shohim faqen 083086.

24 Të nderuar Gjykatës, unë kam dhe pesë minuta. A e shtyjme
25 dot edhe vetëm pesë minuta pushimin që t'i përfundoj pyetjet?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 Z. ROBERTS: [Përkthim]

3 PY. E shihni dokumentin që keni përpara, që ka datën 11 maj
4 1999? Brigada Kumanova 121, me numër protokolli 21/2-2-77. A e
5 shihni këtë përpara?

6 PË. Po.

7 PY. Ky është fletë-arrest kundër Azem Ollurit që është një
8 nga personat që kemi diskutuar në kuadër të çështjes së
9 Krojmirit, apo jo?

10 PË. Ky dokument thirret në vendimin e datës 1 maj për
11 transferimin e tij në një njësi tjetër të brigadës. I cili nuk
12 e ka zbatuar vendimin në fjalë, dhe komandanti ka vendos për
13 një gjë të tillë. Do të thotë, kjo mbështetet në vendimin e
14 datës 1 maj.

15 PY. Po. Por është fletë-arrest që është, sigurisht, është
16 lëshuar në bazë të këtij vendimi, por është në kuadër të
17 Brigadës 121, pra Brigada 121 është ajo që ka marrë masa
18 kundër këtij personi.

19 PË. Risistemimin e të gjithë këtyre personave, natyrisht që e
20 ka bërë Brigada 121, sepse i kanë takuar Brigadës 121. Mirëpo,
21 për dijeninë e Trupit Gjykses, ky fletë-arrest nuk është
22 zbatuar sepse personi në fjalë ka sjell raporte mjekësore
23 mendoj, mendoj nuk jam i sigurt, ka sjell raporte mjekësore,
24 apo nuk jam i sigurt për këtë. Ajo që dua ta ripërsëris,
25 ndërlidhet me vendimin e datës 1 maj.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shohim faqen e parë edhe një herë,
2 ju lutem. Është faqja 083085, është pjesë e grupit të
3 dokumenteve që nuk janë pranuar.

4 PY. Dokumenti mban datën 19 maj 1999. Edhe ky dokument lidhet
5 me Dalip Durmishin, që ishte një nga personat që ishte liruar.
6 Flitet këtu për mënyrën se si i është konfiskuar arma. E
7 shihni?

8 PË. Po.

9 PY. Edhe ky dokument lidhet me faktin që policia ushtarake
10 vazhdoi të merrte masa kundër këtyre personave edhe pas
11 lirimit të tyre prej z. Selimi.

12 PË. Ky dokument nuk ka të bëjë me marrjen e masave, ky
13 dokument ka të bëjë me dorëzimin e revoles së z. Durmishi në
14 Brigadën 121. Revolet ose pistoletat të ndaluarve u janë marrë
15 me rastin e ndalimit të tyre. Dhe në momentin e lirimit, në
16 momentin e lirimit, nuk u janë kthyer revolet atyre. Sepse
17 sipas rregullores së brendshme të UÇK-së, të drejtën e
18 posedimit të pistoletave e kanë pasur nga komandanti i togut e
19 lart, si dhe policët ushtarakë. Megjithatë atyre iu hoq statusi
20 i policit ushtarak, ata në bazë të asaj rregullore nuk kishin
21 të drejtë të posedonin pistoleta.

22 PY. Unë po përpiqem të them se fakti që këta persona ishin
23 liruar nuk e pengoi, nuk i pengoi hetimet tuaja, dhe nuk ju
24 pengoi të merrnit masa kundër tyre në nivel brigade, a
25 pajtoheni me propozimin tim?

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts (Vazhdim)

Faqe 31

1 PË. Ata janë liruar për shkelje penale ndërsa janë ndëshkuar
2 për shkelje disiplinore.

3 PY. Këto shkelje disiplinore u sanksionuan në nivel brigade,
4 pra. Pra, fakti që ata u liruan nuk ishte pengesë për marrjen
5 e masave disiplinore, apo jo? A pajtoheni me mua?

6 PË. Kjo ishte në kompetencën e komandantit të brigadës, i
7 cili edhe i ka shfrytëzuar ato kompetenca, dhe mendoj që ka
8 vepruar në mënyrën e duhur.

9 PY. Faleminderit z. Krasniqi.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.
11 Unë përfundova me pyetjet e mia.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
13 z. Roberts.

14 Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim. Ju lutem mos
15 flisni me askënd për dëshminë tuaj me persona jashtë sallës së
16 gjyqit.

17 Mund të largoheni me Sekretaren e Gjykatës.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund të kërkoj pranimin e dy
20 faqeve që përdora me Dëshmitarin, ju lutem?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
22 kundërshtime?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
25 Atëherë, dy dokumentet pranohen me numër 083086, 083085.

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon (Vazhdim)

Faqe 32

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Unë propozoj që të
2 bashkohen këto dy faqe me provën P020 -- domethënë P02010, më
3 falni.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi asnjë problem me këtë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Këtë bëni.

7 Mirë, bëjmë dhjetë minuta pushim.

8 --- Pauza fillon në orën 10.05

9 --- Seanca rifillon në orën 10.18

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
11 Sekretares të sjellë dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
14 vazhdojmë me pyetjet e Mbrojtjes së z. Veseli, Dëshmitar.

15 z. Dixon, e keni ju fjalën.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

17 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

18 PY. Mirëmëngjes, z. Krasniqi. Unë quhem Rodney Dixon. Do t'ju
19 bëj disa pyetje në emër të klientit tim, zotit Kadri Veseli.

20 PË. Mirëmëngjesi.

21 PY. Shpresoj që përgjigjet tuaja të jenë të shkurtra dhe të
22 qarta. Do ju kërkoja, nëse është e mundur, që t'i përgjigjeni
23 pyetjeve që ju bëj unë sa më shkurt të jetë e mundur, në
24 mënyrë të tillë që të përfundojmë sa më shpejtë të jetë e
25 mundur.

1 Z. Krasniqi, dua të filloj duke thënë që ju jeni caktuar
2 si ndihmës i komandantit i policisë ushtarake në Brigadën 121.
3 Kjo ka ndodhur në nëntor-dhjetor të vitit 1998, apo jo? A
4 është e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Jam caktuar që të punoj së bashku me komandantin, pa
6 ndonjë pozitë të qartë. Sidoqoftë, neve kemi punuar së bashku
7 deri kah fundi apo fillimi i shkurtit të vitit 1999.

8 PY. Faleminderit. Ky person ka qenë Nexhmi Krasniqi, i cili
9 në fillim të shkurtit vijoi duke u bërë shefi i policisë
10 ushtarake në nivel zone dhe ju në atë kohë e zëvendësuar atë
11 në nivel brigade. A ka ndodhur kështu, është e saktë kjo, z.
12 Krasniqi?

13 PË. Po. Unë e kam zëvendësuar si ushtrues detyre i
14 komandantit të togut, pozitë të cilën e kam mbajtur deri në
15 fund të luftës.

16 PY. Deri në fund të luftës, kështu?

17 PË. Saktë.

18 PY. Z. Haxhi Shala, komandanti i Brigadës, ka qenë personi i
19 cili ka caktuar ju në atë post. A është e saktë kjo?

20 PË. Po, e saktë.

21 PY. Ai këtë ua bëri gojarisht, domethënë foli, bisedoi me
22 juve dhe ju tha gojarisht se ju do jeni personi që do jeni ose
23 do luani rolin e komandantit të policisë ushtarake? Kështu ka
24 ndodhur, apo jo?

25 PË. Për të qenë më i qartë, unë kam hezituuar ta pranoj

1 fillimisht këtë detyrë, prandaj ndoshta dhe jam caktuar
2 ndoshta si ushtrues detyre. Mirëpo në ato rrethana ka pasur
3 sigurisht edhe të tjerë që kanë nguruar t'i pranojnë detyrat
4 dhe përgjegjësitë, sepse nuk ka qenë e lehtë të veprohet në
5 ato rrethana. Mirëpo ky lloj emërimi është bërë në mënyrë
6 verbale. Nuk kam pas diçka të shkruar me shkrim.

7 Dua të shtoj, më fal, z. Avokat, dua të shtoj që mund ta
8 këtë pasur --

9 PY. Po, patjetër --

10 PË. Mund ta këtë pasur karakterin formal një lloj emërimi i
11 tillë kur është bërë në komandën e brigadës përkatësisht në
12 takimet e komandës së brigadës, duke u mbajtur ndonjë -- duke
13 u mbajtur procesverbal, sepse e konsideroj që në shumicën e
14 rasteve, për të mos thënë rregullisht, janë mbajtur
15 procesverbale dhe nëse është marrë një vendim i tillë në
16 mbledhjet e komandës së brigadës dhe është evidentu në atë
17 procesverbal, mund të them se ka pasur edhe një karakter
18 formal një caktim i tillë.

19 PY. Po, por ju nuk keni parë ndonjë gjë me shkrim. Ndonjë
20 urdhër për caktimin tuaj, me shkrim. Ju është bërë me gojë, ju
21 është komunikuar me gojë ky pozicion. Domethënë nuk është se
22 po them që ka pas ndonjë gabim aty apo jo, por si çështje
23 fakti, unë besoj që, ose po ju pyes në qoftë se juve ju është
24 komunikuar me gojë emërimi juaj në këtë pozicion.

25 PË. Edhe një herë po e përsëris, emërimi ose më është

1 komunikuar me gojë ose është evidentuar në ndonjë procesverbal
2 të mbledhjes së komandës së brigadës. Nuk mund të jem më
3 specifik. Kaq.

4 PY. Në rregull. Faleminderit. Në shkurt ose mars të asaj
5 kohe, domethënë të vitit 1999, ju në mënyrë të ngjashme jeni
6 caktuar nga Z. Shala, që ishte komandanti i brigadës, që të
7 bëheshit komandant i ZKZ-së, në brigadë. A është e saktë kjo?
8 PË. Po, por për dallim prej herës së parë, këtu z. Shala më
9 ka caktuar me shkrim.

10 PY. Në rregull. Do t'i kthehem kësaj çështje pak më vonë,
11 megjithatë, për momentin dua të sqarojmë që ai në fakt ka
12 folur personalisht me ju lidhur me këtë emërim dhe ju ka
13 shpjeguar që ai donte që ju të merrnit këtë post dhe
14 gjithashtu ju ka dhënë mundësinë që ju t'i përgjigjeshit këtij
15 propozimit të tij. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Sa i përket emërimit të Z. Shalaj, i cili ma ka bërë në
17 sektorin e ZKZ-së, nuk mbaj mend të kem diskutuar me z. Shala
18 paraprakisht, përveç emërimit që kam pranuar.

19 PY. Po. Pra, ju thoni që nuk keni pasur biseda të mëparshme
20 me të, por ai ju ka treguar që ju do merrni ose ju ka thënë që
21 ju do e merrni këtë post dhe ju keni pranuar këtë propozim,
22 apo jo?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të kemi një citim, një
24 referencë për këtë?

25 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, po e pyes dëshmitarin nëse i

1 kujtohet që të ketë ngjarë kështu siç përshkrova.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
3 kundërshtimi. Ju lutem përgjigjuni, Dëshmitar.

4 DËSHMITARI: Siç e thashë, nuk përjashtohet mundësia, por
5 unë nuk e mbaj mend të jetë bërë ndonjë diskutim i tillë, duke
6 mos e përjashtuar mundësinë.

7 Z. DIXON: [Përkthim]

8 PY. Në rregull. Faleminderit.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Ka një referencë për këtë që e ka
10 numrin P02006.3, faqja 7, ku dëshmitari flet lidhur me
11 emërimin e tij në vitin 1999 nga z. Shala.

12 PY. Tani dua t'ju pyes, në qoftë se ju kujtohet, në kohën kur
13 e keni marrë këtë post, domethënë si komandant i ZKZ-së, ju
14 nuk e morët këtë -- nuk zëvendësuar dikë që ishte në atë
15 pozicion më përpara apo keni qenë i pari që jeni emëruar në
16 këtë post. A ju kujtohet kështu? A është e saktë kjo, apo jo,
17 Dëshmitar?

18 PË. Nuk jam i sigurt, nuk e di.

19 PY. Megjithatë, a ju kujtohet që ju nuk keni folur me dikë
20 tjetër që ka qenë në atë post përpara jush. Domethënë nuk
21 është se ju është deleguar puna ose është dorëzuar puna nga
22 dikush tjetër që mund të ketë qenë në vend -- në këtë vend
23 përpara jush. A ka ndodhur kështu apo jo? Është e saktë kjo?

24 PË. Nëse mendoni të ketë pasur një lloj pranim dorëzimi
25 detyrës nga paraardhësi, diçka e tillë nuk ka ndodhur.

1 Domethënë, pajtohem me ju.

2 PY. Faleminderit. Keni diskutuar në shumë hollësi në dëshminë
3 e dhënë rolin tuaj si komandant i policisë ushtarake. Nuk do e
4 kaloj gjithë këtë informacion përsëri me ju, por do ju kërkoja
5 që të përqendrohemi te roli dhe detyrat tuaja në sektorin e
6 ZKZ-së, si komandant në brigadë për ZKZ-në.

7 Për procesverbal, këtu i referohem shënimit në seancë
8 përgatitore, shënimit përgatitor që ka dorëzuar Prokuroria për
9 juve, në paragrafin 115, për personat që na ndjekin. Ju aty e
10 përshkruani rolin tuaj si fiktiv dhe një rol që nuk -- për të
11 cilin nuk është se ju jeni trajnuar gjatë luftë. Domethënë nuk
12 jeni trajnuar për detyra të lidhura me ZKZ-në gjatë luftës. A
13 është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Ju thoni se ishte detyrë fiktive. Ishte kështu sepse
16 emërimi juaj në këtë post ka qenë vetëm thjesht për faktin e
17 plotësimit të strukturës formale të brigadës dhe përmbushjes
18 së organigramës, pra të plotësimit të organigramës, dhe ju nuk
19 kishit një strukturë funksionale nën vete për ushtrimin e
20 kësaj pune. A është një përmbledhje ose vlerësim i drejtë e
21 situatës kjo që sapo thashë?

22 PË. Po.

23 PY. Ju nuk jeni trajnuar gjatë luftës për të kryer detyrat të
24 lidhura me ZKZ-në. Trajnimi është bërë vetëm më vonë,
25 domethënë, pas luftës, dhe për shërbime informative civile. A

1 është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, e saktë.

3 PY. Sa i takon punës suaj në fushën e inteligjencës ose
4 informative, do t'ju citoj diçka që i keni thënë ZPS-së në
5 intervistën me të. Do ta lexoj ngadalë.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk është e nevojshme që të
7 paraqitet në ekran. Megjithatë, për palët që na ndjekin, pjesa
8 që po lexoj është te prova gjyqësore P02006.3, faqja 11,
9 rreshti 6 e në vijim.

10 PY. Z. Krasniqi, ju jepni këtë përgjigje kur pyetët lidhur me
11 rolin tuaj. Ju thoni si më poshtë:

12 "Shih, detyra e çdo shërbimi inteligjence është që të
13 mbledhë informacion dhe kjo ishte, mendoj unë, më shumë si
14 përshkrim në organigramën e UÇK-së në atë kohë. Nuk kishte
15 kapacitete për sa i takon veprimeve të vërteta.

16 Megjithatë, ne jemi përpjekur që t'i përmbushnim këto
17 detyra dhe në qoftë se e mblidhnim një informacion të caktuar,
18 e delegonim, e përcillnim atë. Megjithatë, me sa më kujtohet
19 ne nuk kemi marrë informacion të rëndësishëm. Ndoshta detyra
20 ishte që të na jepej ne informacion lidhur me mënyrën si
21 silleshin ushtarët e sa i takon disiplinës së tyre, dhe ishte
22 thuajse e pamundur për ne për të mbledhur informacion nga
23 armiku. Ishte e pamundur. Gjatë kohës kur unë kam shërbyer në
24 atë detyrë, mund të them që ky ishte sektori që kishte mundësi
25 shumë të kufizuara."

1 Besoj që e shikoni edhe në ekran këtë, Dëshmitar, apo jo?

2 A ju kujtohet t'ia kenë thënë këtë ZPS-së?

3 PË. Në ekran nuk e kam të paraqitur, mirëpo, më kujtohet që e
4 kam thënë një gjë të tillë.

5 PY. Atëherë ju kërkoj falje, në fakt, sepse e kisha fjalën
6 për transkriptimin më shumë sesa për materialin në ekran.

7 Megjithatë ju e dhatë përgjigjen.

8 Kam një ose dy pyetje të tjera plotësues që kanë të bëjnë
9 me këtë pjesë të dëshmisë suaj. Kur thoni që keni pasur
10 mundësi të kufizuara, a do të thotë kjo që në realitet ju e
11 kishit të pamundur të kryenit punë, shërbim kundërzbulimi
12 gjatë periudhës kur keni qenë në luftë? A është kështu?

13 PË. Unë mendoj që e kam thënë në një formë dhe kjo shkon
14 përtej mundësive të kufizuara sepse edhe mundësitë e kufizuara
15 më duket tepër, prandaj e kam thënë në një rast se po të
16 hiqeshin disa nga informacionet që i ka sjellë z. Baftiu,
17 atëherë kjo pozitë në Brigadën 121 mund të quhet pozitë
18 fiktive. Megjithëse, edhe ato pak informacione që janë sjellë
19 nga personi në fjalë, nuk është se përmbajnë ndonjë
20 informacion të rëndësishëm. Ai sigurisht se informacionin e
21 njëjtë do t'ia përcillte UÇK-së në cilëndo njësi që do të
22 haste. Dhe nuk nënkupton se ka qenë ndonjë informacion i
23 nivelit që i takon shërbimeve informative apo zbulim-
24 kundërzbulimit.

25 PY. Në rregull. Do t'iu pyes pak më tepër lidhur me rastin e

1 Shabit Salës [Sipas përkthimit] që e diskutuam pak më përpara,
2 dhe do ju pyes pak më tepër lidhur me z. Baftiu më vonë.
3 Megjithatë, sa për ta sqaruar dhe sa për marrjen e
4 informacionit dhe kur thoni që aftësitë ose mundësitë kanë
5 qenë ekstremisht të kufizuara, ju këtë informacion në qoftë se
6 e merrnit si komandant brigade -- domethënë, ja jepnit këtë
7 informacion z. Shala, si komandant i Brigadës, në qoftë se e
8 grumbullonit një informacion të tillë. Kjo është një procedurë
9 e pazakontë, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. -- kjo ishte procedura e zakonshme, domethënë, që
12 ndiqnit. Domethënë, ju thjesht e kalonit ose e përcillnit
13 informacionin deri te komandanti i Brigadës dhe nuk e kalonit
14 më tej në hierarki. A është e saktë kjo, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe sigurisht që këtë informacion ju nuk ja keni kaluar
17 z. Kadri Veseli, që ishte shefi ose drejtuesi i ZKZ-së, apo
18 jo, Dëshmitar?

19 PË. Pajtohem.

20 PY. Do kërkoja që të shikojmë një pjesë të shënimit
21 përgatitor të bërë me Prokurorinë që është paragrafi 112 për
22 palët që na ndjekin, do t'ua lexoj, Dëshmitar, në mënyrë të
23 tillë që ta dëgjoni një herë dhe të mund të komentoni. Ju
24 thoni që:

25 "Jeni takuar një herë me z. Halil Qadrakun rastësisht në

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon (Vazhdim)

Faqe 41

1 Tërpezë ose Fshati i Ri gjatë luftës. Qadraku u prezantua si
2 shefi i ZKZ-së për zonën e Pashtrikut. Asnjë lloj informacioni
3 tjetër nuk është shkëmbyer lidhur me ZKZ-në. Ju nuk keni pasur
4 dijeni lidhur me detyrimet e Qadrakut dhe në qoftë se Qadraku
5 i ka raportuar Shtabit të Përgjithshëm apo jo. Po ashtu thuhet
6 aty që ju nuk jeni përditësuar ose nuk jeni i informuar nga
7 Qadraku. I keni komunikuar çështjet dhe problemet e lidhur me
8 ZKZ-në dhe policinë ushtarake z. Haxhi Shala.”

9 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

10 PË. Siç e kam theksuar, takimi me z. Qadraku ka qenë i
11 rastësishëm dhe absolutisht nuk ka pas të bëjë një lloj takimi
12 për shkak të pozitës që ai mbante e që unë u informova në atë
13 moment nga ai. Domethënë, asnjëherë gjatë luftës nuk ka pas
14 asnjë korrespondencë formale apo zyrtare apo bashkëpunim me z.
15 Qadraku gjatë luftës, në kuadër të këtij sektori.

16 PY. Po. Faleminderit.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares tani të
18 paraqesë në ekran një dokument që e ka treguar edhe
19 Prokuroria. Bëhet fjalë për dokumentin P02010, faqen 083044.

20 PY. Është një vendim që ka të bëjë me togën policore tuajën.
21 Besoj që duhet ta shikoni tani në ekran. E shikoni, Dëshmitar?

22 PË. Nuk kam vendim para vetes.

23 PY. Besoj që duhet të jetë duke u shfaqur tani nga Prokuroria
24 -- nga Sekretarja, më falni. Dje ju janë bërë pyetje lidhur me
25 këtë vendim. Nuk dua që t'i përsëris edhe një herë pyetjet që

1 iu janë bërë por thjesht dua të konfirmoj me ju që është e
2 saktë se në postin tuaj si komandant i ZKZ-së, juve nuk keni
3 nxjerrë asnjëherë një vendim të ngjashëm me këtë. Domethënë,
4 ku i keni caktuar personave të caktuar që të kryejnë detyra të
5 caktuara si -- në emrin tuaj. Ju një vendim të tillë, si
6 komandant i ZKZ-së, nuk e keni nxjerrë ndonjëherë, apo jo,
7 Dëshmitar?

8 PË. As si komandant i ZKZ-së, as si komandant i togut të
9 policisë ushtarake. Konsideroj që ndoshta është hera e vetme
10 që është quajtur vendim. Nuk do të thotë që emërimi është i
11 saktë. Domethënë, këtu janë disa detyra që i janë dhënë
12 skuadrës së Bellanicës, skuadrës së policisë ushtarake në
13 Bellanicë, për ruajtjen e rendit në ato rrethana.

14 PY. Pra, kjo është absolutisht e veçantë, ose le të themi
15 ndryshe nga detyrat e tjera që ju keni pasur, apo jo,
16 Dëshmitar? Kështu e keni kuptuar edhe juve sa i takon aspektit
17 të ZKZ-së. A është e saktë kjo?

18 PË. E saktë, po.

19 PY. Po ashtu, është e saktë, apo jo, z. Krasniqi, që duke
20 marrë parasysh atë çfarë i keni shpjeguar Trupit Gjykses sot,
21 pra, se cilat kanë qenë detyrat tuaja ose çfarë keni bërë ju
22 në atë kohë që ka pasur shumë luftime kundër forcave serbe,
23 por pjesa dërmuese e kohës tuaj zihej me punët që ju kishit me
24 policinë ushtarake, apo jo? Domethënë, e shpenzonit pjesën
25 dërmuese të kohës tuaj me detyra që kishin të bënin me

1 policinë ushtarake. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Fillimisht koha shpenzohej me luftimet kur kishte
3 luftime. Ato kanë qenë prioritare dhe më pastaj me detyra dhe
4 punët e policisë ushtarake. Përkatësisht, me detyrat që janë
5 deleguar apo janë dhënë nga Brigada.

6 PY. Po. Meqë e kemi dokumentin në ekran, ju keni përmendur
7 disa persona që kanë qenë në policinë ushtarake. Na ndihmoni,
8 ju lutem, a ka pasur ndonjë fshati juaj Banjë, z. Lulzim. Ka
9 qenë ndonjë Lulzim në policinë ushtarake, a kishte ndonjë
10 lidhje me policinë ushtarake ndonjë formë -- Lulzim? Lulzim
11 Shurdhaj mbase?

12 PË. Ku, më falni, ku po e lexoni këtë?

13 PY. Jo, nuk po e lexoj, jo. Nuk është në dokument. Thjesht po
14 ju pyes unë vetë. Më duket se e keni -- ju keni përmendur disa
15 emra dhe po ju pyes edhe unë për një z. Lulzim Shurdhaj. Nuk
16 po e shqiptoj unë saktë, siç duhet. Lulzim Shurdhaj, ka qenë
17 ndonjë person që punuar në policinë ushtarake apo që e keni
18 njohur?

19 PË. Personin Lulzim Shurdhaj nuk e kam përmendur asnjëherë.
20 Është nga fshati Banjë dhe nuk i ka takuar policisë ushtarake
21 që unë kam udhëhequr me të.

22 PY. Po, po, po. A ka qenë në policinë ushtarake, apo në UÇK,
23 nëse e keni këtë informacion? A ka qenë në ndonjë njësi të
24 policisë ushtarake a të UÇK-së në fshatin tuaj?

25 PË. Unë për atë sa mbaj mend, z. Lulzim Shurdhaj ka qëndruar

1 në UÇK deri me përfundimin e ofensivës së parë, ose
2 eventualisht pak para përfundimit të ofensivës së parë, dhe
3 është larguar nga vendi. Nuk i di rrethanat e largimit të tij,
4 dhe me aq sa e di, nuk është rikthyer më në UÇK.

5 Sa i përket punëve dhe detyrave të tij deri në momentin e
6 largimit nga UÇK, nuk i di. Nuk e di rolin e tij.

7 PY. Faleminderit. Tani do t'iu bëj disa pyetje për
8 kolaboracionistët e pretenduar, sepse kjo është një nga temat
9 që trajtoi ZPS-së me ju.

10 Në intervistën për ZPS-në ju keni thënë lidhur me këtë
11 temë --

12 Z. DIXON: [Përkthim] -- dhe për palët që po na ndjekin,
13 kjo që po lexoj gjendet në provën P02007.4, faqja 1, rreshti
14 20 e në vijim.

15 PY. Unë po e lexoj dhe pastaj do t'iu bëj pyetje. Ju thatë:

16 "Më duket se e kam shtjelluar pak këtë dje, se kjo fushë
17 ka qenë krejt e panjohur për ne. Nuk kishim materiale që t'i
18 përdornim si bazë në mënyrë që të merrnim informacione të
19 rëndësishme. Por duke marrë parasysh kushtet dhe rrethanat e
20 asaj kohe, nëse dikush donte t'i transmetonte informata UÇK-
21 së, ishte më thjeshtë që ky informacion t'i transmetohej apo
22 t'i jepej, t'i përcillej një ushtari të UÇK-së apo një polici
23 ushtarak, sesa t'i jepej ZKZ-së. Pra, ishte më e lehtë policit
24 apo UÇK -- të UÇK-së, më falni, apo policit ushtarak sesa ZKZ-
25 së."

1 Ju kujtohet kjo?

2 PË. Këtë e kam thënë në kuptimin se ai ka qenë mundësia më e
3 lehtë, ose takimi i parë me këtë nivel. Dhe me rastin e
4 takimit të parë me dikë të uniformuar, atëherë ai e ka dhënë
5 informacionin. Në këtë kontekst e kam thënë.

6 PY. Po. Dhe ju keni thënë "nëse dikush kishte informata, ai -
7 - ky -- këto informata mund t'i përcilleshin edhe ZKZ-së, por
8 edhe pa ZKZ-në". A ju kujtohet ta keni thënë?

9 PË. Po, po, po. E saktë.

10 PY. Pra, në rolet tuaja, ju personalisht nuk dilnit jashtë,
11 nuk dilnit për të mbledhur informata për kolaboracionistët.
12 Domethënë, nuk ishit pro aktiv. Është ky një vlerësim i
13 drejtë?

14 PË. Po, i drejtë dhe i saktë.

15 PY. Keni përmendur z. Naim Baftiu në dëshminë tuaj, lidhur me
16 rastin e z. Sabit Shala. Është -- ju bëri një pyetje
17 Prokuroria lidhur me mënyrën se si e takuat apo si morët
18 informata prej tij, si pjesë e ZKZ-së:

19 "Në këto momente unë u ngrita në këmbë për ta
20 kundërshtuar ...", nëse ju kujtohet. Ju thatë:

21 "Ajo që është e rëndësishme është që Naim Baftiu sillte
22 informata kur isha pjesë e ZKZ-së, por edhe kur nuk isha pjesë
23 e ZKZ-së, sepse detyra e tij, apo qëllimi i tij ishte të
24 ndihmonte UÇK-në."

25 Z. DIXON: [Përkthim] Kjo është thënë në provën P02007.4,

1 pjesa 4, faqja 3.

2 PY. Ju kujtohet ta keni thënë këtë në intervistën tuaj?

3 PË. Përveç më kujtohet një gjë e tillë dëshmohet, domethënë,
4 nga fakti sepse z. Baftiu ka sjellur informata edhe para se
5 unë të caktohem në sektorin e ZKZ-së.

6 PY. Në intervistë ju keni thënë edhe më tej, lidhur me rolin
7 e tij, ju kanë pyetur:

8 "A ka qenë ushtar i UÇK-së?"

9 Ju jeni përgjigjur:

10 "Nuk ka qenë, nuk ka qenë ushtar i rregullt me uniformë.
11 Ishte pjesë e formacioneve të UÇK-së."

12 Është -- jeni pyetur pastaj:

13 "A ishte informator?"

14 Dhe ju jeni përgjigjur që:

15 "Po, u kthy -- u bë informator" dhe ju ndihmonte ju.

16 A e përshkrova saktë, kjo ka qenë vërtetë roli i tij?

17 PË. Mund të them se është filluar si informator. Mandej, ka
18 qenë bashkëpunëtor i rregullt, dhe deri në përfundimin e
19 luftës sigurisht që ka marrë edhe statusin e pjesëtarit të
20 UÇK-së. Por nuk ka qenë, siç ka qenë, siç e kam theksuar, me
21 uniformë dhe me armë në pikat e UÇK-së apo në vijat a frontit.

22 PY. Pra, ai nuk ishte caktuar si anëtar i policisë ushtarake
23 apo i ZKZ-së? Ai ishte thjeshtë një ndihmës vullnetarisht.

24 Vullnetarisht ju ndihmonte ju të merrnit herë pas here

25 informata. Saktë?

1 PË. Nuk ka pasur ndonjë emërim formal. Ai e ka ndihmuar UÇK-
2 në ashtu si e kanë ndihmuar të tjerët, qoftë nga Zvicra apo
3 nga vende të tjera. Domethënë, në këtë rast, edhe Naim Baftiu
4 e ka ndihmuar UÇK-në me mundësitë që ka pasur në dispozicion.
5 PY. Faleminderit. Sa i takon arrestimit të z. Sabit Shala. E
6 kemi diskutuar gjerësisht këtë. Ju dhatë dëshmi se jeni
7 urdhëruar nga z. Dobruna ta arrestoni z. Shala. Nuk është
8 nevoja ta trajtojmë edhe një herë këtë. Por a mund të themi që
9 lidhur me këtë arrestim konkret, ju i keni thënë kështu ZPS-
10 së. Do ta lexoj.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Për palët, po lexoj nga prova
12 P02007.4, faqja 4, rreshti 18 e më poshtë.

13 PY. Ju keni thënë kështu:

14 "Që kur -- meqë u bë ky arrestim, ky arrestim, urdhër me
15 gojë për arrestim, u konfirmuan dyshimet edhe nga Naim Baftiu
16 në raportin paraprak që ishte përgatitur kundër Sabit Shalës,
17 dhe ky raport iu dorëzua Sokol Dobrunës. Iu referova
18 informacionit që mora nga shërbimi i zbulimit dhe në bazë të -
19 - në bazë të këtij informacioni, u mor vendimi nga organi
20 kompetent, pra ishte një pjesë që nuk lexohet këtu. Pra u mor
21 -- vendimi i formës së prerë u mor nga organi kompetent.

22 Sa i takon informacionit që na u dha nga Naim Baftiu, nuk
23 gjykuam se kishte rreziqe të tjera në bazë të informacioneve
24 prej tij."

25 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

1 PË. Po, por duhet të sqaroj një çështje. Së pari, në
2 periudhën që po i referohemi, nuk ka pasur *de facto* shërbim
3 informativ. Një gjë e tillë është thirrur në informatat që ka
4 sjellë Baftiu, sepse Baftiu ishte bashkëpunëtor edhe para se
5 unë të caktohesha në atë sektor dhe duke mos e njohur këtë
6 fushë dhe duke qenë se kishin ardhur informacione nga një
7 bashkëpunëtor, atëherë janë quajtur si informata nga shërbimi
8 informativ. Por duhet të theksohet se nuk ka pasur shërbim
9 informativ dhe vetë emërimi i brigadës kur e ka bërë si shef i
10 sektorit të shërbimit informativ është kontradiktor, sepse nuk
11 ka pasur ende shërbim informativ në këtë periudhë. Zyrtarisht
12 nuk ka qenë i themeluar. E kam thënë edhe me disa raste se
13 terminologjitë mund të ketë qenë shumë herë të gabuara, por
14 kah kontekstet duhet të nxirret qëllimi. Sepse nuk kemi qenë
15 profesionistë dhe njerëz të fushës në kuadër të rrethanave në
16 atë periudhë.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Mirë, e nxjerrim dokumentin në
19 ekran. Ju lutem, 2D00020 .

20 PY. Z. Krasniqi, do të dalë në të majtë të ekranit. Ky është
21 kallëzimi penal që keni nënshkruar ju për z. Shala.

22 Bazuar në dëshminë që dhatë deri tani, a mund të themi
23 nëse shikojmë në një fjali në mes të fjalisë: "Këtë e
24 dëshmojnë deklaratat e dhëna nga i akuzuari, të dhënat nga
25 Shërbimi Informativ i UÇK-së -- UÇK-së". Në fakt, ju me këtë

1 fjali keni dash të thoni që ka qenë thjesht informacione të
2 marra nga z. Baftiu. Nuk ka pasur strukturë ekzistuese në atë
3 kohë, siç thatë edhe ju. Saktë?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. Që ta përfundojmë këtë temë --

6 Z. DIXON: [Përkthim] Ndërkohë mund të hiqet dokumenti.

7 PY. Në Shënimin Përgatitor 2, paragrafi --

8 PË. A mund ta riktheni dokumentin edhe një herë?

9 PY. Po, po. Do ta shohim dokumentin pastaj shohim shënimin
10 përgatitor. Kishit ndonjë gjë për pyetjen time?

11 PË. Po, sepse ky rast, siç shihet nga data, ka ndodhur -- apo
12 -- jo duhet të ketë ndodhur, por ka ndodhur pasi që unë jam
13 caktuar në sektorin e ZKZ-së. Këtë desha ta sqaroj dhe ta
14 konfirmoj.

15 PY. Po, është data 20 mars --

16 PË. Prandaj --

17 PY. -- 1999. Faleminderit.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

19 PY. Tani shohim shënimin përgatitor, paragrafin 65. Ju thatë
20 -- keni thënë se informatat që keni marrë nga z. Baftiu ishin
21 informata që janë përdorur si bazë për arrestimin e z. Shala,
22 dhe keni thënë që:

23 "Ju do ta kishit arrestuar z. Shala, pavarësisht
24 informacionit që morët nga Baftiu, sepse Dobruna kishte
25 lëshuar urdhër për arrestimin e tij dhe ju kishte dhënë edhe

1 arsyet pse do ta arrestonit. Saktë?

2 PË. Baza për arrestimin e z. Shala nuk kanë qenë informata e
3 z. Baftiu, por urdhri i z. Dobruna.

4 PY. Faleminderit. Përpara pushimit do të doja të shihnim, z.
5 Krasniqi, edhe një dokument tjetër që ua ka treguar
6 Prokuroria, por nuk kërkuan pranimin e këtij dokumenti si
7 provë gjyqësore. Madje Gjykatësi Mettraux edhe pyeti
8 Prokurorinë për këtë.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00226490 në
10 anglisht, edhe origjinali në shqip, ju lutem.

11 PY. Z. Krasniqi, dje ju thatë që këtë dokument nuk e kishit
12 parë më përpara por që besoni se e ka lëshuar z. Sokol
13 Dobruna. Shohim edhe datën këtu. Është 19 dhjetor e vitit
14 1998. E shihni?

15 PË. Po, nëse nuk jam gabim, këtë dokument duhet ta kem parë
16 për herë të parë në rastin Kleçka.

17 PY. Pra, ju mendoni se e keni parë në rastin Kleçka, ku qenë
18 i përfshirë vetë ju?

19 PË. Pikërisht, po.

20 PY. Këtu thotë:

21 "Personat përgjegjës për policinë ushtarake duhet të
22 lajmërojnë gjykatën ushtarake me rastin e arrestimeve, në
23 mënyrë që ajo të merret me vërtetimin e fakteve relevante për
24 të vërtetën materiale, siç është e autorizuar në bazë të Kodit
25 Penal Ushtarak të UÇK-së".

1 Dje ju thatë që nuk keni pasur ndonjë kod penal në atë
2 kohë. A e vërtetë që një kod po përpilohej, po përgatitej por
3 nuk ishte përfunduar?

4 PË. Kjo nuk do të thotë që nuk e ka poseduar gjykata. Këtë
5 nuk e di. Kam thënë se nuk e kemi poseduar ne si njësi e
6 policisë ushtarake.

7 PY. Këtu shohim që udhëzimi ka ardhur nga z. Dobruna për
8 rastet e arrestimit. A është e vërtetë që ai mund të
9 urdhëronte -- mund t'iu urdhëronte ju të arrestonit persona
10 siç ndodhi me rastin e Sabit Shalës?

11 PË. Siç e kam cekur, vetëm ky rast ka qenë kur ai ka
12 urdhëruar, por nuk ka ndodhur në raste të tjera. Ndonëse ne
13 mund të them me përgjegjësi të plotë dhe mund të dëshmoj këtu
14 para Gjykatës, sa me përpikëri janë zbatuar këto udhëzime.

15 Pavarësisht që unë nuk e kam parë këtë udhëzim të shkruar, nuk
16 më kanë munguar udhëzimet verbale që m'i ka dhënë z. Dobruna.

17 PY. Po, dokumenti përputhet me atë që ju kujtohet edhe ju
18 lidhur me marrjen e udhëzimeve dhe ushtrimin e detyrës suaj si
19 komandant i policisë ushtarake. Saktë?

20 PË. Pikërisht është ashtu dhe mund të shtoj se udhëzimet që
21 unë kam marrë nga z. Dobruna shtrihen përtej këtij udhëzimit
22 të shkruar që e kemi para vetes në ekran.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po shoh që ka
25 vajtur ora për pushimin, por përpara do kërkoja që të pranohej

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon (Vazhdim)

Faqe 52

1 dokumenti si provë gjyqësore, bazuar në dëshminë e
2 dëshmitarit. Ky dokument është relevant, me vlerë provues edhe
3 autentik.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
5 kundërshtime.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ekipet e
8 tjera? Jo.

9 Në rregull. dokumenti SPOE000226490 pranohet.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
11 do të marrë numrin e provës 2D00042 e klasifikimi është
12 konfidencial.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Do të vazhdoj pas pushimit me
14 pyetjet e mia.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Dëshmitar, tani do bëjmë gjysmë -- gjysmë ore pushim,
17 njësoj si edhe dje. Mund të largoheni nga salla e gjyqit tani,
18 me Sekretaren e seancës.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
21 deri në orën 11.30.

22 --- Seanca mbyllet në orën 11.02

23 --- Seanca rifillon në orën 11.31

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A do
25 përfundoni brenda orës që sugjeruat më përpara apo jo?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Do e kaloj pak kohën e parashikuar
2 sepse kjo ka të bëjë me numrin e pyetjeve që janë bërë nga
3 ZPS-ja, pra edhe ZPS-ja e zgjati më shumë kohën që kishte
4 vlerësuar. Besoj që do më duhet rreth 30 minuta, 45 minuta të
5 tjera plus, duke reflektuar çështjet që u ngritën nga
6 Prokuroria.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë. Mundohuni që të
9 kufizoni në gjysmë ore.

10 Z. DIXON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk mund t'ju
11 them me siguri.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E di që do
13 bëni më të mirën e mundshme.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Megjithatë e di që dy ekipet e tjera
15 të Mbrojtjes kanë pak pyetje për të bërë, kështu që kam
16 përshtypjen që duhet të merret dhe kjo parasysh sa i takon
17 kohës që do më lejoni mua.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi,
20 do të vazhdojmë më tej me pyetjet e z. Dixon. Ju lutem
21 dëgjojini me vëmendje pyetjet.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
23 PY. Z. Krasniqi, kam disa pyetje të tjera për ju. Do filloj
24 me atë çfarë keni thënë dje lidhur me z. Kadri Veseli, kjo
25 është dhënë në faqen 73 të transkriptit provizor. Do ju kujtoj

1 se çfarë keni thënë dhe pastaj kam disa pyetje. Në përgjigje
2 të pyetjes ju thoni si më poshtë dhe pyetja është kjo:

3 " ... përpara kësaj dite a keni pasur ndonjë takim tjetër
4 me z. Veseli të ngjashëm me këtë takim?"

5 Atë ditë, ju përmendët një kohë të caktuar kur jeni
6 takuar me z. Veseli. Ju thatë që takimi ka ndodhur disa ditë
7 pas disa dokumenteve të cilat ju janë treguar lidhur me rastin
8 Krojmir, i fundit dokument është dokumenti që ju i keni
9 dorëzuar para, pra, që e keni dorëzuar përpara Gjykatës më
10 datë 6 maj. Mesa kuptoj unë, ju keni takuar disa ditë pas
11 datës 6 maj z. Veseli.

12 Dhe pastaj ju bëhet pyetja a e keni takuar ndonjëherë z.
13 Veseli dhe ju thoni:

14 "Një takim për të diskutuar një çështje të ngjashme? Jo.
15 Mund ta kem parë atë, po nuk jam marrë me këtë rast konkret
16 ose me çështjen konkrete."

17 Dhe pastaj vazhdohet me pyetjen tjetër:

18 "A e keni takuar z. Veseli në ndonjë rast tjetër përveç
19 këtij takimi?"

20 Dhe ju thoni:

21 "Mund ta kem parë. Por për të qenë më konkret, pas luftës
22 ai më kërkoi që t'i bashkohesha SHIK-ut, që të bëhesha pjesë e
23 SHIK-ut?"

24 "Dhe a u bëtë juve eventualisht pjesë e SHIK-ut?"

25 Dhe ju thoni:

1 "Po, e kam pranuar ofertën ose propozimin që mu bë, më
2 kujtohet, drejt fundit të vitit 1999 dhe i dhashë përgjigjen
3 ose vendimin tim që të bëhesha pjesë e SHIK-ut diku nga viti
4 2000 ose pranvera e vitit 2000, në qoftë se nuk gabohem."

5 A ju kujtohet t'ju jenë bërë këto pyetjet e të keni dhënë
6 këto përgjigje, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Faleminderit. Dua t'ju pyes lidhur me këtë takim që ju
9 thoni që e keni pasur disa ditë pas dokumentit që i referohet
10 rastit Krojmiri. A është e drejtë të thuhet që z. Veseli nuk
11 ka qenë i përfshirë në asnjë prej hetimeve në këtë rast dhe
12 nuk është përfshirë në asnjë prej vendimeve të marra për këtë
13 rast, a është e saktë kjo?

14 PË. Po.

15 PY. Sikurse e thatë, ju keni pasur një bisedë të përgjithshme
16 ku i është dhënë një informacion i përgjithshëm, i është
17 përcjellë një informacion i përgjithshëm atij, a është kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Është saktë të thuhet, apo jo, që mbështetur në atë çfarë
20 keni thënë dje, z. Veseli nuk ishte i përfshirë në hetimet e
21 asnjë prej rasteve të tjera për të cilat ju keni dijeni ose
22 nuk ka qenë i përfshirë në asnjë prej vendimeve të marra
23 lidhur me këto raste. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Ai nuk ka qenë i përfshirë në asnjë prej vendimeve për të

1 ndaluar persona në Kleçkë apo për të liruar persona që

2 mbaheshin aty. A është e saktë kjo?

3 PË. Po.

4 PY. Keni thënë që ju jeni kyçur në SHIK në fund të vitit 2000

5 ose diku, domethënë, nga pranvera e vitit 2000. Keni thënë që

6 e keni pranuar propozimin e bërë nga z. Veseli. Dua që të

7 shikojmë një pjesë të intervistës që i keni dhënë ZPS-së

8 lidhur me këtë aspekt.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Për Sekretarinë është prova

10 P02006.3, nga faqja 18 e në vazhdim.

11 PY. Atëherë ju keni thënë këtë gjë. Unë do t'ju lexoj, më

12 dëgjoni dhe pastaj do ju bëj disa pyetje:

13 "Pasi e pranova propozimin e bërë nga z. Veseli, ai më

14 tha që të prisja dhe që të përfundoja trajnimin dhe vetëm pas

15 përfundimit të trajnimit ... ju mund të ishit aktiv për

16 detyrat në terren. Pas një periudhe të shkurtër, unë u ftova

17 dhe e bëra trajnimin në Prishtinë. Zakonisht trajnimi zgjaste

18 dy deri në tre muaj. Pas përfundimit të këtij trajnimi, unë

19 fillova që të punoja."

20 Pyetje:

21 "Cila ishte natyra e detyrave tuaja?"

22 Përgjigje:

23 "Detyrat e mia përqendroheshin në dy fusha:

24 antiterrorizëm dhe krim të organizuar. Këto ishin dy fushat

25 kryesore të detyrave të mia. Dhe trajnimi në thelb është bërë

1 vetëm për këto dy fusha kryesisht. Është bërë nga
2 ndërkombëtarët ... nga një agjenci miqësore ndërkombëtare dhe
3 janë trajnime të cilat janë ofruar në gjuhën angleze ... Tani
4 kemi përkthyes. Por nuk e di dhe kemi pas dhe përkthyes por
5 nuk e di se nga cilat vende vinin ato sepse nuk më lejohej që
6 t'i bëja pyetje se nga vinin ata. Sigurisht, që eprorët e
7 lartë duhet ta kenë ditur se nga ishin ata."

8 A ju kujtohet t'ia keni dhënë këtë dëshmi ZPS-së,
9 Dëshmitar?

10 PË. Po. Saktë.

11 PY. Pra, kjo është hera e parë që ju keni qenë në këto
12 trajnime, trajnime që ofroheshin nga këta ndërkombëtarë, më
13 përpara ju nuk keni qenë fare i trajnuar për çështje
14 informative të inteligjencës, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po, e saktë.

16 PY. Sa për të qenë tërësisht i saktë lidhur me këtë, tani
17 flitet për SHIK-un, pra, për Shërbimin Civil Informativ
18 Kombëtar. Kjo nuk kishte të bënte fare me aspektin ushtarak të
19 shërbimit informativ, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Një prej gjërave të tjera që keni thënë dje lidhur me z.
22 Veseli në faqen 73 është që ju keni thënë që:

23 "Gjatë luftës ai është njohur fillimisht si drejtuesi ose
24 udhëheqësi i ZKZ-së. Më pas dhe pas krijimit të SHIK-ut ai ka
25 qenë drejtuesi i SHIK-ut."

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon (Vazhdim)

Page 58

1 A ju kujtohet ta keni thënë këtë dje?

2 PË. Po.

3 PY. A ju kujtohet, mbase mund ta dini dhe për këtë arsye dua
4 t'ju pyes, a ju kujtohet se kur z. Veseli është zhvendosur nga
5 shefi i ZKZ-së që është aspekti ushtarak i shërbimit
6 informativ në UÇK në pjesën civile të shërbimit informativ,
7 kur ka ndodhur kjo? Ka ndodhur në prill të vitit 1999?

8 PË. Nuk e di saktë, por një gjë e tillë duhet të ketë ndodhur
9 pas formimit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

10 PY. Ai u bë ministër i Shërbimit Informativ të Kosovës në
11 Qeverinë e Përkohshme në fillim të prillit, a është e saktë? A
12 ju kujtohet kështu, Dëshmitar?

13 PË. Po. Sigurisht që me rastin e formimit të Qeverisë së
14 Përkohshme ka pasu një emërim i tillë.

15 PY. Po. Kjo ka ndodhur pas bisedave në Rambuje të cilat janë
16 zhvilluar në shkurt. A ju kujtohen të jenë zhvilluar këto
17 biseda, Dëshmitar?

18 PË. A ka mundësi edhe një herë pyetjen të lutem?

19 PY. A ju kujtohen diskutimet ose bisedat e zhvilluara në
20 Rambuje lidhur me të ardhmen e Kosovës, biseda të cilat janë
21 zhvilluar në shkurt?

22 PË. Po, natyrisht që më kujtohen.

23 PY. A ju kujtohet, mbase e dini që z. Veseli ka qenë aty,
24 domethënë, ka qenë në Rambuje, ka qenë jashtë shteti gjatë
25 kësaj kohe dhe më pas është kthyer në Kosovë për t'u bërë

1 pjesë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
3 deklaratë kjo, ka pyetje apo është thjesht deklaratë faktesh?

4 Z. DIXON: [Përkthim] Po e pyes lidhur me këtë
5 dëshmitarin.

6 PY. E di këtë gjë, Dëshmitar?

7 PË. E di që ka qenë në Rambuje, mirëpo periudhat e sakta nuk
8 mund t'i di kur ka shku apo kur është kthyer, do të thotë, nuk
9 mund të flas me saktësi të datave.

10 PY. Po. Faleminderit. Z. Krasniqi, a mund ta sqaroj që kur
11 flasim për periudhën këtu mars, prill, maj, përfshirë edhe
12 këtë takim që keni pasur me z. Veseli, në atë kohë e vetmja
13 marrëdhënie që keni pasur me të, pra, me z. Veseli, ose i
14 vetmi takim që keni pasur me të ka qenë disa ditë pas datës 6
15 maj, a është e saktë kjo?

16 PË. Unë mund ta kem parë paraprakisht dhe sigurisht që e kam
17 parë, mirëpo nuk kemi pasur asnjëherë një takim për të
18 trajtuar diçka të tillë të ngjashme apo diçka formale nëse
19 mund ta quajmë.

20 PY. Atëherë ta kuptoj këtë që, në atë kohë, është e saktë,
21 apo jo, që ju nuk keni marrë asnjë urdhër nga z. Veseli në
22 detyrat që ju kryenit asokohe, a është e saktë kjo?

23 PË. Po, e saktë.

24 PY. Tani do të kalojmë tek tema që ka të bëjë me z. Shala,
25 Sabit Shalën, do t'ju pyes disa pyetje lidhur me drejtuesin e

1 burgut të Kleçkës, z. Agim Zogaj.

2 Së pari, dëshiroj që të sqaronim në mënyrë të tillë që ta
3 kuptoj se ku keni qenë ju në atë kohë. Në paragrafin 64 të
4 Shënimit Përgatitor numër 2 dhe, në fakt këtë e keni thënë
5 edhe më herët gjatë dëshmisë tuaj, është e saktë, apo jo,
6 Dëshmitar, që juve nuk ju kujtohet në hollësi në qoftë se ju
7 personalisht e keni dërguar z. Shala në burgun e Kleçkës por
8 është e mundur që të ketë ngjarë kështu. Kjo është dëshmia
9 juaj, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Sa i takon z. Zogaj, që ishte drejtuesi i burgut të
12 Kleçkës, ne e dimë - që e keni thënë dhe më përpara - që ju
13 jeni vendosur përpara gjykatës lidhur me atë çfarë ka ndodhur
14 atje dhe pjesë e dëshmisë në gjykim ka qenë dëshmia e dhënë
15 nga z. Zogaj. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, e saktë.

17 PY. Keni thënë në dëshminë tuaj, më konkretisht - kjo jepet
18 në provën P2007.4 në faqen 18, rreshti 22 e në vazhdim - pra,
19 keni thënë që dëshmia është konstatuar të ketë qenë e
20 gënjeshtërt nga shkalla e parë edhe nga gjykatat e shkallëve
21 më të larta. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Ju i konsideroni deklaratat e dhëna nga z. Zogaj lidhur
24 me atë çfarë ka ndodhur atje, si të pavërteta. A është e saktë
25 kjo?

1 PË. Natyrisht të njëjtën gjë ka konstatuar edhe Trupi Gjykses
2 në katër raste, do të thotë, një gjë e tillë është konstatuar
3 me katër aktgjykime.

4 PY. Të shohim njëërën prej këtyre aktgjykimeve së bashku.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoj
6 Sekretares që së pari të paraqesë në ekran dokumentin
7 SITF00391837, që është aktgjykimi i Gjykatës Themelore me një
8 trup gjykses të përbërë prej EULEX-it dhe gjyqtareve lokal.
9 PY. Është thjesht faqja kryesore, ballina sa për të filluar
10 faqja e parë. Vendimi është i disponueshëm vetëm në anglisht
11 kështu që do ta kalojmë bashkë ndërkohë që të tjerët mund ta
12 ndjekin.

13 Atëherë kjo është faqja e parë e Gjykatës Themelore të
14 Prishtinës, është një vendim i 17 shtatorit 2013. Këtu mund të
15 shikoni se cila ishte përbërja e Trupit Gjykses që përbëhej
16 prej gjyqtarëve të EULEX-it. A është kjo një prej lëndëve
17 gjyqësore të cilën ju keni përmendur, Dëshmitar?

18 PË. Data 17 shtator 2013 është data kur u shpall aktgjykimi i
19 shkallës së parë për herë të dytë, do të thotë, ka qenë rasti
20 i rigjykuar në shkallë të parë. Sepse në herën e parë është
21 vendosur në maj të vitit 2012.

22 PY. Ky është rasti ku keni absolutisht, domethënë, keni të
23 drejtë, bëhet fjalë për rigjykimin e lëndës. Kjo është e
24 saktë, apo jo?

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. Dua t'ju tregoj pjesë të caktuara të aktgjykimit, duke
2 filluar me faqen SITF00391920. Sikurse e thashë dhe më herët,
3 do jetë në anglisht vetëm, megjithatë do jua lexoj me zë
4 kështu që mund ta merrni përmes përkthimit përmbajtjen e
5 aktgjykimit.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Është faqja 134 e aktgjykimit, në
7 pjesë të ndryshme në fakt. Mendoj që referenca është e saktë.
8 Pra dhe një herë faqja është 391920 dhe faqja është 134.
9 Atëherë ERN e plotë është 391887. Kam përshtypjen që është
10 920.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na thoni se
12 cili është numri i dokumentit në PDF.

13 Z. DIXON: [Përkthim] 134. Ju kërktoj ndjesë se aktgjykimi
14 është i ndarë në dosje të ndryshme.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti ka 50 faqe.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Po më duhet t'ju jap edhe numrin ERN
17 për 50 faqet e ardhshme. Fillon me 00391887. Po, kjo është
18 faqja e duhur.

19 E thashë edhe një herë që nuk ka përkthim në shqip për
20 këtë pjesë -- ah, ka një përkthim në shqip për këtë pjesë dhe
21 e kam fjalën konkretisht për 003311775. Dhe do i kërkvoja
22 Sekretares ta vendosë në të djathtë të ekranit këtë pjesë të
23 përkthyer në shqip. ERN e plotë është 00331737, duke filluar
24 nga kjo faqe. Dhe pastaj është 1775. Domethënë, vetëm dy faqe
25 do ju kërktoj që të shfaqni, kështu që besoj që pasi të

1 gjendjet faqja e duhur do jetë e thjeshtë për të vijuar më
2 tej. Është faqja 331175. Atëherë është 0033175.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nuk e gjej dot.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Do e provoj dhe një herë të fundit
5 për të thënë referencën e plotë të versionit në shqip. Është
6 00331735 -- është 9? Ju kërktoj ndjesë. Se mezi e deshifrova
7 shkrimin me dorë. Referenca është kjo: 00391737 deri në
8 00391786. Faqja është 00391775. Besoj prandaj nuk e gjetët dot
9 sepse e thashë gabim numrin 9.

10 Atëherë në qoftë se do shkojmë në fund të kësaj faqeje.
11 Këtu është 1775 apo jo? Atëherë është në fillim të faqes në
12 versionin në shqip dhe në fund në anglisht.

13 PY. Pjesa përkatëse që dua që t'ju lexoj dhe do ju kërktoj që
14 të komentoni, Dëshmitar, është kjo pjesa:

15 "Ka mospërputhje dhe kundërthënie substanciale në
16 dëshminë e Agim Zogajt. Dëshmia e tij ka qenë -- gjithashtu
17 kundërshtohet nga dëshmitë e tjera. Dëshmia e tij ishte plot
18 gënjeshtër. Ai vetë e ka pranuar që i gënjyer hetuesit në të
19 kaluarën."

20 Z. DIXON: [Përkthim] Të vazhdojmë më poshtë në tekst. Të
21 kalojmë një faqe në versionin në anglisht.

22 PY. "Megjithatë, në lidhje me shumë gjëra të rëndësishme të
23 cilave i referohemi këtu, dëshmia e Agim Zogajt është jo vetëm
24 e paqëndrueshme por dukshëm e kundërshtuar nga dëshmi të
25 tjera. Mospërputhjet dhe kundërshtimet e gjetura nga gjykata

1 nuk janë mospërputhje që mund të jenë produkt i një kujtese të
2 ndershme por jo perfekte, një vëzhgim apo riprodhim i
3 ngjarjeve për të cilat ai ka dëshmuar.”

4 Po vazhdoj më tej:

5 “... Trupi Gjykues konstaton se shumë prej ngjarjeve që
6 përmend Agim Zogaj në ditaret e luftës janë të sakta. Për
7 shembull, dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët sa i takon datave,
8 kur ata thonë që janë ndaluar në burgun në Kleçkë është në
9 përputhje me shënimet në ditar, përfshirë këtu dhe informacion
10 që ka të bëjë me identitetin e persona të tjerë të ndaluar
11 gjatë të njëjtës periudhe. Megjithatë, asnjë prej këtyre
12 provave nuk mbështet dëshminë e Agim Zogaj lidhur me personin
13 kush, sipas tij, pra, personin që sipas tij ka kryer veprat e
14 ngritura në këtë aktakuzë.

15 “Çdo konstatim i këtij Trupi Gjykues sa i takon
16 identitetit të kryerësve të krimeve të përmendura në këtë
17 aktakuzë mbështetet kryesisht në dëshminë e Agim Zogajt.
18 Besueshmëria e tij si rezultat është shumë e rëndësishme për
19 çështjen e Prokurorisë. Duke shqyrtuar të gjithë dëshminë në
20 këtë rast, Trupi Gjykues konstaton se Agim Zogaj nuk është një
21 dëshmitar i besueshëm dhe për pasojë nuk do ishte e sigurtë që
22 të mbështetni vetëm tek dëshmia e tij.”

23 Atëherë pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: A
24 është ky aktgjykimi ose rigjykimi i lëndës së Kleçkës që ju
25 thatë që vendimi është marrë në favorin tuaj?

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon (Vazhdim)

Faqe 65

1 PË. Po, saktësisht.

2 PY. Do ju bëj disa pyetje të tjera për çështje që janë
3 ngritur.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do i kthehem
5 këtij diskutimi ose kësaj çështjeje pak më pas sa i takon
6 pranueshmërisë sepse nuk dua që të ndërpresë bisedën që kam me
7 dëshmitarin.

8 Por tani dua që të kërkoj që të shfaqet në ekran një
9 tjetër dokument. Që është P00980, në faqet 00009589 deri në
10 9590. Është një raport i z. Zogaj që përmendet në dëshminë e
11 dhënë prej dëshmitarit.

12 Të nderuar Gjykatës, këto janë të gjitha materialet të
13 cilat kanë ardhur nga dëshmia e z. Zogaj sipas rregullit 155.

14 Në të djathtë kemi raportin e punës së z. Zogaj. Na duhet
15 faqja tjetër për përkthimin në anglisht në mënyrë të tillë që
16 mund të na ndjekin të gjithë. Është një dokument që ka shumë
17 faqe që janë pranuar sipas rregullës 155.

18 9590. Po, kjo është faqja.

19 PY. Z. Krasniqi, këtë dokument ua treguan dhe më herët. Ju,
20 kam përshtypjen, se thatë nuk e keni parë më përpara. Është
21 një raport pune që është pranuar si provë gjyqësore për këtë
22 lëndë që pretendohet të jetë shkruar nga z. Agim Zogaj. A e
23 shikoni këtë dokument në ekran përpara, Dëshmitar?

24 PË. Po, e shikoj.

25 PY. Nëse do shikoni pikën, shënimin e bërë tek 13, Sabit

1 Shala, aty shihni datën kur ai është çuar atje që është 21
2 mars 1999 dhe më pas përmendet data e lirimit që është 2 prill
3 1999, e shikoni?

4 PË. Po, e shikoj.

5 PY. Së pari, për të qenë i qartë, ju pra, shikoni që Habib
6 Shala është sipër dhe ju thoni që kjo datë duhet të jetë e
7 gabuar sepse sipas mënyrës që ju kujtohen ju ngjarjet, ai
8 është sjellë në burg pas Sabit Shalës, a është kështu?

9 PË. Ai Habi, jo, por Habib duhet të jetë. Ai është dërguar në
10 burg pas Sabit Shalës dhe kjo është e saktë.

11 PY. Po. Shohim pikën 7, Milan Mitrovic, data kur e kanë marrë
12 kanë qenë 21 mars 1999 dhe është liruar në 2 prill 1999. E
13 patë?

14 PË. Po.

15 PY. Tani, z. Zogaj ka dhënë dëshmi për këtë çështje
16 gjyqësorë, për këtë lëndë gjyqësore dhe ka thënë se z.
17 Mitrovic është sjellë në Kleçkë nga klienti im, z. Veseli dhe
18 janë dhënë udhëzime se kur të lirohej, pra, që të lirohej kur
19 të kishte një ofensivë serbe. Kjo është dëshmi që e ka dhënë
20 z. Zogaj.

21 Tani pyetja që kam unë për ju është kjo: Shihni pak datën
22 e Sabit Shalën, kur kanë sjellë Sabit Shalën, është fiks e
23 njëjta datë me z. Mitrovic për të dy është data 21 mars. E
24 shihni?

25 PË. Po.

1 PY. Pra, sipas këtij raporti, i kanë sjellë në të njëjtën
2 ditë, sipas raportit. E shihni?

3 PË. Personi nën numrin 7, nuk është i njëjtë versioni shqip
4 me versionin në anglisht. Po mendoj në shtyllën e fundit është
5 një mospërputhje.

6 PY. Na e thoni ju mospërputhjen, nuk mund ta bëjmë ne. Nuk e
7 flasim shqipen. Na e thoni cila është mospërputhja?

8 PË. Po shtylla e fundit në versionin shqip është Shtabi i
9 Përgjithshëm, ndërsa në versionin anglisht është në kllapa
10 edhe një emër.

11 PY. E kuptoj. Do ta verifikojmë këtë. Nuk ka problem.

12 Unë do t'ju pyesja këtë sidoqoftë, ju thoni që mund ta
13 keni çuar z. Sabit Shala atje më 21 mars, po e keni parë ju të
14 sillnin dhe z. Mitrovic në të njëjtën ditë?

15 PË. Së pari, nuk jam i sigurtë a e kemi dërguar, a është
16 dërguar më 21 mars apo më 20 mars. Së dyti, z. Habib Shala
17 është dërguar nga dikush tjetër më vonë, pas disa dite. Dhe,
18 së treti, nuk më ka ndodhë asnjëherë ta shoh dikë tjetër duke
19 e dërguar kushdo qoftë në qendrën e njëjtë, përfshirë edhe
20 këtë rast.

21 PY. Ju asnjëherë s'e keni parë vetë z. Veseli të ketë çuar
22 ndonjë në ambientet e ndalimit, apo jo?

23 PË. Fillimisht unë nuk e di dhe a është i saktë dhe i vërtetë
24 një gjë e tillë. Unë këtë dokument e kam parë për herë të parë
25 në rastin Kleçka. Mirëpo pyetjen konkrete që ju e shtroni,

1 është e vërtetë që asnjëherë nuk e kam parë duke e dërguar
2 dikë në atë qendër.

3 PY. Faleminderit. E lëmë mënjane përmbajtjen e dokumentit,
4 por faleminderit që e thatë.

5 Më vonë, kur u liruan personat në prill, ju keni qenë në
6 zonën e Kleçkës në këtë periudhë kur u liruan personat?

7 PË. Unë në zonën e Kleçkës kam qenë deri në përfundim të
8 luftës, apo më saktësisht, deri në pjesën e parë të muajit
9 qershor 1999.

10 PY. Po. Po ju vetë me sytë tuaj e keni parë të lirohej z.
11 Mitrovic?

12 PË. Unë jo që nuk e kam parë të lirohet, por edhe nuk kam
13 dëgjuar për diçka të tillë sepse për ta parë nuk kam pasur
14 sesi ta shoh. Por, më korrekte do të ishte sikur të pyetesha a
15 kam dëgjuar.

16 PY. Mirë atëherë. A keni dëgjuar diçka? Na ndihmoni, ju
17 lutem.

18 PË. Absolutisht nuk kam dëgjuar në kohën e luftës, përveç në
19 rastin Kleçka, për herë të parë kam dëgjuar dhe e kam parë
20 këtë dokument në rastin Kleçka.

21 PY. Do t'ju bëj dhe një pyetje tjetër, se mbase ju ndihmon të
22 kujtohet diçka.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Të lutem të kalojmë në seancë
24 private për të qenë të sigurtë për pyetjet që do bëj tani.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë

1 arsye?

2 Z. DIXON: [Përkthim] Dëshmitari që do të përmend.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
4 seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Dixon, meqë e kemi ende
6 dokumentin në të djathtë.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka problem se kam një
9 koment. Dua t'ju pyes nëse mund të nxirrni versionin origjinal
10 të dokumentit se është në faqen 589, mbase do ju ndihmojë dhe
11 do të ndihmonit dhe Trupin Gjykses për të parë se çfarë ka
12 dokumenti në shqip sepse nuk është.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Me kënaqësi do ta bëjmë këtë, po unë
14 s'kam probleme me përkthimin lidhur me pyetjet e mia. Po
15 sigurisht që do nxjerrim dhe përkthimin e saktë në ekran
16 patjetër.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe me ç'kuptova unë, përkthimi i
19 saktë është në faqen 9589. Mbase ka pasur dy përkthime,
20 prandaj nuk doja që të fokusohesha për momentin. Mund ta
21 verifikoni vetë pak më vonë.

22 Ja, ky është versioni i saktë në shqip, është në të
23 djathtë. Po nuk kam ndonjë paqartësi për këtë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faqja në anglisht është
25 një faqe më poshtë.

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Kam dhe një aspekt tjetër, z.

12 Krasniqi. Vetë z. Dobruna ka dhënë dëshmi për këtë aspekt, kjo

13 është e pranuar në provën P01955.8, Pjesa 8, faqja 18, atij i

14 është bërë pyetja nëse referenca këtu apo përmendja këtu e

15 "Shtabit të Përgjithshëm" dhe "Lulit" kishte të bënte me z.

16 Kadri Veseli, ai ka thënë:

17 "A keni dijeni", kur është pyetur:

18 "A keni dijeni procesverbal ndonjë rast ku të ketë qenë i

19 përfshirë Kadri Veseli?"

20 Ai tha:

21 "Jo, jo. Biles unë jam i befasuar nga kjo. Si ka mundësi

22 që ai të ketë shkuar madje atje?"

23 Më pas ai vazhdon dhe thotë:

24 "Nuk mbaj mend të jetë përmendur një herë Kadri Veseli.

25 Jo."

1 A keni diskutuar ju ndonjëherë çështjen e Mitrovic me z.
2 Dobruna? Tani unë ju lexova çfarë ka thënë ai. Mos ju kujtohet
3 ta keni diskutuar me të?

4 PË. Jo, vetëm çështja e Milan Mitrovic që nuk është diskutuar
5 material të, por sa më kujtohet, asnjëri nga këta emra përveç
6 numrit 13 dhe mandej në një formë numri 12 nuk janë diskutuar
7 me të. Do të thotë edhe numri 5. Më fal. Raste tjera asnjëherë
8 nuk janë trajtuar apo diskutuar, jo trajtuar po diskutuar me
9 z. Dobruna me emra të përveçëm. Nuk janë trajtuar asnjëherë.

10 Z. Dobruna kur kemi zhvilluar biseda janë zhvilluar në
11 kontekstin e rregullave që duhet të zbatohen, por jo me emra
12 të përveçëm.

13 PY. Z. Dobruna, po ashtu ka thënë që nuk ka folur asnjëherë
14 me z. Veseli për gjykatën.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Kjo është e thënë në provën P1955.9,
16 faqja 4.

17 PY. A është e vërtetë që as ju nuk keni pasur ndonjë bisedë
18 me z. Veseli për gjykatat dhe çfarë ndodhte me personat
19 përpara gjykatës?

20 PË. Jo. Me z. Veseli nuk kam pasur bisedë asnjëherë në lidhje
21 me procedurat e tilla.

22 PY. Faleminderit, z. Krasniqi. Kam dhe një temë tjetër që dua
23 ta diskutojmë bashkë që lidhet me dokumentin që keni sjellë ju
24 kur keni ardhur për këtë Gjykatë. Është letra e emërimit tuaj,
25 domethënë. Për këtë dua të flasim, është me numër P0215. A ju

1 kujtohet që e parë dje këtë?

2 PË. Po. E saktë.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta nxjerrim sërish në ekran në
4 mënyrë që të shohim formulimin. Referenca 124987. Edhe një
5 herë, është prova me numër P2015. Po.

6 PY. Kjo është letra e emërimit që keni gjetur ju dhe që ua ka
7 dhënë z. Shala, saktë?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Këtu thuhet se vendimi është marrë nga Shtabi i
10 Përgjithshëm i UÇK-së më 11 shkurt 1999. E shihni?

11 PË. Po.

12 PY. A ju është dhënë ndonjë gjë me shkrim ju nga Shtabi i
13 Përgjithshëm në atë datë apo qoftë edhe ndonjë datë tjetër
14 lidhur me emërimin tuaj?

15 PË. Unë mesa kujtoj e kam thënë edhe më herët, se përveç
16 këtij emërimi nuk posedoj dhe nuk kam poseduar asnjë dokument
17 tjetër, që nënkupton se nuk më është dhënë asnjë dokument
18 tjetër nga askush.

19 PY. A e dini këtë informacion atëherë, nëse e dini, është
20 bërë një mbledhje e Shtabit të Përgjithshëm me disa anëtarë të
21 Shtabit të Përgjithshëm më 11 shkurt? Ka qenë Bislime Zyrapin si
22 shef shtabi dhe ai ka dhënë dëshmi për këtë mbledhje, në këtë
23 mbledhje janë diskutuar çështje kadrovike. Keni dëgjuar
24 ndonjëherë lidhur me këtë?

25 PË. Mund të kem dëgjuar, mirëpo nuk mund të kujtoj ndonjë

1 detaj relevant.

2 PY. Z. Zyrapi ka dhënë dëshmi lidhur me këtë.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Kjo është e reflektuar në transkript
4 në faqen 17656.

5 PY. A e dini ju se në atë kohë, më 11 shkurt të 1999 ka qenë
6 në mes të bisedimeve të Rambujesë dhe, mesa ju kujtohet ju, z.
7 Veseli në atë kohë nuk ka qenë brenda vendit, saktë?

8 PË. Mund të ketë qenë ashtu. Por siç e thashë edhe më herët
9 nuk i di saktësisht lëvizjet e anëtarëve të Shtabit të
10 Përgjithshëm

11 PY. Po. E kuptoj këtë. Po atëherë a e dini ju se z. Zyrapi
12 nuk ka pranuar të nënshkruajë disa emërime për emërimet në
13 nivel zone dhe batalionesh dhe ka thënë se këto janë çështje
14 që me të cilat duhen të merren zonat, brigadat dhe batalionet.
15 Nuk është kjo punë e Shtabit të Përgjithshëm? Keni dëgjuar
16 diçka lidhur me këtë?

17 PË. Nuk mund të them asgjë në këtë drejtim, për faktin që nuk
18 po më kujtohet.

19 PY. E kuptoj këtë që s'keni qenë vetë në mbledhje. Thjesht
20 doja ta dija a keni pasur ndonjë informacion, për shembull,
21 për faktin që z. Zyrapi nuk ka nënshkruar disa emërime sepse
22 ka thënë se kjo i takon z. Shala.

23 PË. Mund të ketë ndodhur por që mua nuk po më kujtohet diçka
24 konkrete në këtë drejtim.

25 PY. Në rregull. Ju përmendët më herët Rambujenë dhe faktin që

1 po zhvillohej në muajin shkurt, a e dini ju që në shkurt në
2 Shtabin e Përgjithshëm u bë një lloj komploti, një lloj
3 grushti edhe ka ndodhur nga 6 shkurti e në vijim, ku z.
4 Sylejman Selimi u bë shefi i UÇK-së dhe i mori detyrën Azem
5 Sylës dhe më pas u zhvendos edhe u hoq edhe komandant Drini
6 nga zona e tij. A ju kujtohet kjo?
7 PË. Më kujtohet. Më kujtohet kur z. Selimi ka ardhur në krye
8 të UÇK-së përkatësisht komandant i Shtabit të Përgjithshëm por
9 nuk mund t'i di datat me saktësi se kur ka ndodhur një gjë e
10 tillë.

11 PY. A po e dini që ka ndodhur dy javët e para të shkurtit? E
12 kujtoni dot?

13 PË. Për korrektësi nuk mund të specifikoj periudha, por kjo
14 s'do të thotë që nuk ka ndodhur në atë periudhë.

15 PY. A ju kujtohet në atë kohë, në shkurt, kur jeni emëruar
16 ju, që në Shtabin e Përgjithshëm ishte pak situata e
17 rrëmuishme, kaotike sepse po bëheshin shumë ndryshime?

18 PË. Unë sipas dokumentit që posedoj nuk jam emëruar në
19 shkurt, por jam emëruar në mars. Ky dokument e vërteton
20 dëshminë time të dhënë qysh në vitin 2011 ku kam thënë se jam
21 caktuar në një sektor të tillë nga komandanti i brigadës z.
22 Haxhi Shala. Dhe kjo vërteton atë që unë komandant thënë se më
23 ka emëruar z. Haxhi Shala.

24 Informatat që ju kërkoni të mëtejme mund dhe duhet t'i
25 sqarojë vetëm z. Shala eventualisht edhe përpiluesi i këtij

1 dokumenti me iniciale ÇD, ÇD.

2 PY. Faleminderit, z. Krasniqi. Këto ish in pyetjet e mia.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Do flasim për pranimin e
4 aktgjykimit, por mund ta bëjmë më vonë sepse mbase do ketë
5 kundërshtime lidhur me këtë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 Znj. Alagendra, fjala është për ju.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

9 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

11 PY. Mirëdita, z. Krasniqi. Unë jam Venkateswari Alagendra dhe
12 unë përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Shumë pak pyetja kam për ju.

13 Dje ju treguan provën P0126.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të vendoset prova
15 në ekran.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem mund ta
17 sqaroni dhe një herë çfarë numri thatë, P0216 apo P02016?

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

19 PY. A ju kujtohet që e patë dje këtë dokument, z. Krasniqi?

20 PË. Po.

21 PY. Dje ju thatë që nuk e dini kush e ka shkruar këtë
22 dokument, por që "nga përmbajtja mund të them që përputhet me
23 detyrat që kishim ne".

24 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Për procesverbal kjo është
25 thënë në transkript faqja 24620, rreshtat 21 dhe 24.

1 PY. A ju kujtohet ta keni thënë këtë dje?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. E kuptoj që nuk e dini kush e ka shkruar këtë dokument,
4 po të lutem shohim paragrafin e dytë të këtij dokumenti, ku
5 thuhet:

6 "Ju kemi ftuar të flasim për këtë çështje si të vijoje
7 më tej. E kuptoj që shumica prej jush, pajtohem që shumica
8 prej jush që janë të pranishëm të japin sa më shumë që të jetë
9 e mundshme dhe ne do të themi se kush ka paguar."

10 Mesa kuptojmë ky është një diskutim për kontributet që do
11 bëheshin, a e kam kuptuar unë drejt?

12 PË. Mund të jetë ashtu, përndryshe nuk e kam analizuar në
13 detaje.

14 PY. Prandaj thashë fokusohemi tek ajo që shohim tek
15 dokumenti. Një nga alternativat këtu është që personat e
16 pranishëm të jepshin çka të kishin mundësi, sa të kishin edhe
17 do të konsiderohej si kontribut aq sa të jepnin, saktë?

18 PË. Po ashtu do të duhej të ishte, po, besoj.

19 PY. Më poshtë janë dhe shumat e parave që janë marrë, saktë?

20 PË. Po shihen shumat. Shihen disa shuma të shkruara në
21 dokument.

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim faqen U000-5986, ju
23 lutem. Është pjesë e një grupi dokumentesh që ka ERN U000-
24 5976-U000-6009. Faqja që dua të shohim është U000-5968. Një
25 faqe më përpara, ju lutem.

1 PY. Ky është i njëjti dokument, pjesë e të njëjtit dokument
2 që pamë më përpara dhe këtu janë shumat që janë marrë, janë
3 renditur shumat që janë marrë.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani kalojmë tek faqja
5 tjetër, ju lutem.

6 PY. Shiheni, z. Krasniqi, në krye të faqes shkruhet:
7 "Gjithsej 88.520 *Deutschmark*". E shihni?

8 PË. Po.

9 PY. Pra, mesa kuptojmë ne, kjo është shuma gjithsej e
10 kontributeve që pamë në faqen pararendëse. Pajtoheni?

11 PË. Po, sigurisht që pajtohem.

12 PY. Pra, kjo faqe duket sikur është vazhdimi i faqes që pamë
13 më përpara. Tani unë do t'ju lexoj çfarë thuhet më poshtë:

14 "Për periudhën për 8 muaj luftë, megjithëse kemi ende
15 rezerva. Por mesatarja ka ra në 100 marka gjermane për ushtar,
16 nga 100 që ishin në muaj për ushqime ... për veshmbathje. Të
17 cilat shpenzohen për armatim, barna të mjekëve për ushtarë,
18 veshmbathje, çorape, kapele, këpucë edhe naftë, dru, vaj e të
19 gjitha ato që nevojiten për ushtarët. Megjithëse ka pas raste
20 kur nuk kemi pasur as ushqim për dy a tri ditë. Edhe shuma
21 prej 17.000 markash gjermane është shpenzuar për mjekime,
22 dyshekë, qebe, lëndë djegëse, e tjerë."

23 A pajtoheni me mua që kjo në fakt pasqyron si ka qenë
24 situatë vërtetë në atë kohë? Që fondet përdorëshin për
25 veshmbathje, për ushqim, për mjekime, për gjërat bazike,

1 pajtoheni me mua?

2 PË. Po, natyrisht. Nuk kanë pas për çka të përdoren tjetër.

3 PY. Një pjesë e konsiderueshme e fondeve që janë mbledhur
4 janë përdorur për medikamente, për barna për të trajtuar
5 njerëzit, apo jo, është e saktë kjo?

6 PË. Sigurisht.

7 PY. Është e qartë këtu, apo jo, që ushtarëve ndonjëherë i
8 është dashur që të mos hanin dy apo tre ditë me radhë në
9 mënyrë të tillë që fondet mund të përdreshin për barna, a
10 është e saktë kjo?

11 PË. Mendoj që po. Por nëse më lejohet, do ta bëja një sqarim.
12 Kur kemi të bëjmë me këtë lloj detyre apo urdhri, kjo nuk
13 nënkupton që të gjithë janë të detyruar të japin ndihma për
14 luftën e UÇK-së. Pjesa dërrmuese, pjesa dërrmuese, që unë nuk
15 mund të jem i saktë, e kanë përkrahur dhe ndihmuar UÇK-në në
16 mënyrë vullnetare, në mënyrë vullnetare dhe këtë e kanë bërë
17 me dëshirën më të madhe. Ashtu siç edhe ne jemi kthyer në
18 mënyrë vullnetare në luftë. Unë e kam potencuar një fakt sepse
19 një ndër detyrat e kemi pas edhe një detyrë të tillë për
20 inkasimin e mjeteve për ata të cilët nuk e kanë bërë më herët.
21 Kjo është zbatuar në një masë të kufizuar sepse nuk ka qenë e
22 lehtë të zbatohet në ato rrethana dhe kemi disa raste. Kur
23 them unë kemi disa raste, ato mund të jenë 10, 15, 20, 30
24 raste, por nuk përbëjnë me qindra dhe mijëra raste.

25 Kjo çështje mund edhe të mos jetë zbatuar në brigada

1 tjera apo zona tjera. Unë kam fol vetëm për togun e policisë
2 ushtarake në brigadë. Se a ka qenë një vendim i tillë i drejtë
3 dhe i arsyeshëm, nuk është çështje e imja ta interpretoj. Unë
4 kam dëshmuar që ne kemi poseduar një vendim të tillë apo një
5 detyrë të dhënë nga komandanti i brigadës i cili është thirrur
6 në mekanizmat më lart. Kaq dua të bëj sqarim për këtë Gjykatë
7 dhe të tjerët.

8 PY. Faleminderit shumë, Dëshmitar.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk
10 kam pyetje tjera për këtë dëshmitar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. Misetic?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam pyetje për këtë dëshmitar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje

15 plotësuese nga Prokuroria?

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kam vetëm dy pika shkurtimisht.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

18 vazhdoni.

19 Pyetje vijuese nga znj. Iodice:

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. Z. Krasniqi, sot më herët, pra, sot paradite, ju treguan
22 disa deklarata që janë marrë si pjesë e çështjes Krojmir, data
23 e tyre është nga 2 deri më 8 maj. Gjithashtu na treguat më
24 herët sot dhe kjo për procesverbal është thënë, është e
25 pasqyruar në faqen 28 që të dyshuarit për çështjen Krojmir

1 "janë liruar për çdo veprë penale dhe janë dënuar vetëm sa i
2 takon shkeljeve disiplinore".

3 A ju kujtohet se në cilën pjesë të hetimeve janë marrë
4 këto deklaratat në fillim të majit, domethënë, janë marrë
5 lidhur me pjesën e masave disiplinore apo janë marrë si pjesë
6 e hetimeve për veprat penale.

7 PY. Tash pas kaq vitesh që kanë kalu, nuk do të thotë që
8 gjithçka të më kujtohet në mënyrë të detajuar. Por ajo që
9 qëndroj mbrapa asaj që kam thënë është se, deri në momentin e
10 lirimit të të ndaluarve, të njëjtit janë ndjekur për dyshimin
11 e kryerjes së veprave penale. Dhe pas lirimit të saj është
12 zhvilluar një procedurë disiplinore.

13 Aty ishin dhe disa deklaratat pas ndalimit të të
14 ndaluarve, por që nuk është nënshkrimi im. Tash nuk do të
15 thotë që di gjithçka dhe të mbaj mend gjithçka, sepse në
16 territor kanë vepruar edhe mekanizma tjerë.

17 PY. Faleminderit.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do i kërkoj Sekretares të
19 paraqesë në ekran SPOE00052992 deri në SPOE00053035. Ju kërkoj
20 ndjesë ky është informacion që kemi nxjerrë në shënimin e
21 ri, në listën e re të provave. Atëherë do i kërkoja Sekretares
22 që të kalojmë në faqen në PDF 19 që ka numrin përndryshe
23 SPOE00053010.

24 PY. Z. Krasniqi, kjo është një intervistë që i ka dhënë z.
25 Kadri Veseli Baton Haxhisë. Këtu në fillim të faqes, në

1 përgjigje të pyetjes se:

2 "Kur fillon historiku i SHIK-ut?

3 Z. Veseli përgjigjet:

4 "Ju thashë qysh nga themelimi i UÇK-së ne kemi pasur
5 nevojë për informacione. Pastaj me kalimin e kohës ..."

6 Pastaj pyetja e radhës është kjo:

7 "Kur është bërë Kadri Veseli shef i SHIK-ut?"

8 Z. Veseli, përgjigjet:

9 "Përgjegjësitë ne në fakt i kemi pasur gjatë gjithë kohës
10 së luftës në periudhën 1992 deri në 1998."

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të kalojmë tek faqja tjetër.

12 PY. Përsëri, këtu z. Haxhiu bën këtë pyetje:

13 "Çfarë është G1 dhe G2?"

14 Veseli përgjigjet:

15 "G2 ka qenë Drejtoria e Shërbimit Informativ të Kosovës.
16 Ky vendim është marrë në qershor të vitit 1998 ..."

17 A keni ndonjë arsye për të besuar se z. Veseli nuk ka
18 qenë i saktë lidhur me detyrat sikurse i ka deklaruar në këtë
19 intervistë?

20 PË. Këtë më së miri do ta sqaron ose mund ta ketë sqaruar z.
21 Veseli. Por ajo çfarë mund të them unë për Trupi Gjykses është
22 se në kuadër të UÇK-së, ne e kemi njohur si sektor apo
23 drejtori apo si mund të jetë quajtur e zbulim-kundërzbulimit,
24 me shkurtesat ZKZ, do të thotë, nuk mund të jem specifik.

25 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje tjera për këtë dëshmitar.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet si provë
2 faqja 19, që ka numrin SPOE00053010. Ndërkohë që faqja e dytë
3 është e pranuar në provën P01859.

4 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
5 këshillohen]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
7 kundërshtim për pranimin e dokumentit?

8 Përderisa nuk ka kundërshtime, dokumenti SPOE00053010
9 pranohet në prova gjyqësore.

10 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
11 këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
13 ndjesë. Atëherë SPOE00053010 pranohet në prova gjyqësore. Ju
14 lutem caktojini një numër prove.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
16 nderuar Gjykatës. propozoj që kjo faqe t'i shtohet provës
17 ekzistuese P01959 ku janë pranuar dy faqe të tjera.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Po, ka më shumë kuptim që të
19 bashkohet me këto dy fletët e tjera të cilat janë pranuar në
20 prova gjyqësore.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
22 Gjykatësi Barthe.

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju
24 kërkoj falje. Sepse harrova që të kërkoj që të pranohet si
25 provë gjyqësore faqen të cilën e përdora me dëshmitarin, më

1 konkretisht është faqja U000-5986.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
3 kundërshtim?

4 Ju kërkoj ndjesë. Atëherë dokumenti U000-5986 pranohet.
5 Ju lutem caktojini një numër prove.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 një faqe nga i njëjti dokument është pranuar në një provë që
8 është prova P02016. Mund ta pranojmë këtu, është një rregull?

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull. Pa diskutim
10 përderisa është vazhdim i një faqeje që është pranuar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
12 shtojeni.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Besoj se është momenti i
15 përshtatshëm tani që t'ju kërkoj që të pranohen tre faqe të
16 aktgjykimit -- të rigjykimit për çështjen Kleçka, të cilën e
17 diskutova me dëshmitarin. Do ju kërkoja që t'ju referohesha
18 një vendimi të mëparshëm që keni bërë lidhur me një çështje të
19 ngjashme që është një vendim për parashtrimin e protokolluar
20 F01733, ku keni lejuar pranimin në provë gjyqësore një pjesë
21 të një aktgjykimi për arsye kontestuale, sigurisht që e di që
22 vendimet e një gjykate të EULEX-it nuk janë të detyrueshme për
23 juve. Por, thjesht do ju kërkoja që për arsye konteksti dhe
24 sikurse keni vepruar në të shkuarën, të mund t'i pranoni këto
25 tre faqe si prova gjyqësore. Po ashtu edhe për faktin që z.

1 Zogaj që është dëshmitar sipas rregullës 155 ka ndërruar jetë
2 dhe është e pamundur për mua që t'i bëjë pyetje këtij
3 dëshmitari. Kjo është njëra prej arsyeve, megjithatë duke
4 marrë parasysh edhe dëshminë e z. Dobruna.

5 Pra, sikurse e thashë, për arsye konteksti përderisa e
6 keni lejuar diçka të tillë që të ndodhë më përpara, do ju
7 kërkoja, të nderuar Gjykatës, që të bënit të njëjtën gjë për
8 këto pjesë. Nuk është e thënë që të mbështeteni tek pjesa
9 faktike e aktgjykimit, por vetëm për arsye kontekstuale.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtime?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, kemi kundërshtime. Sepse ne
13 kundërshtojmë mbi bazën e relevancës. Sikurse e tha kolegu im
14 që ju keni vendosur më 5 shtator që aktgjykime të tjera nuk
15 janë të pranueshme.

16 Këto konstatime janë arritur në kontekst të çështjeve
17 përkatëse. Po ashtu, pyetja që iu bë dëshmitarit nuk kishte të
18 bënte fare për të konfirmuar në qoftë se ky ishte aktgjykimi,
19 apo jo, kështu që nuk është se u bë ndonjë koment thelbësor
20 nga dëshmitari për këtë çështje.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Unë në kundërpërgjigje dua të them
22 që dokumenti është relevant sepse ka të bëjë me pretendimin
23 Prokurorisë, pra, Prokuroria mbështetet në këtë pretendim
24 kryesisht. Dhe, së dyti, Prokuroria ka thënë gjithashtu që në
25 fund të pyetjeve të veta i vendosi propozimin, i paraqiti

1 propozimin dëshmitarit sa i takon faktit në qoftë se ai po
2 tregon të vërtetën apo jo. Dhe dëshmitari është deklaruar i
3 pafajshëm në këtë aktgjykim.

4 Mendojmë që është e rëndësishme që kjo të pranohet për
5 arsye kontekstuale, vetëm për arsye të kufizuara.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i
7 caktojme një numër MFI dhe pastaj do vendosim më vonë.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
10 Barthe keni pyetje? Jo, ju kërkoj ndjesë se nuk përfundam
11 akoma.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund ta përmend dhe
13 një herë Avokati numrin e dokumentit, numrin SPOE?

14 Z. DIXON: [Përkthim] Është faqja e parë, është një
15 dokument prej gjashtë pjesësh, megjithatë unë dua që të
16 pranohen SITF00391837.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe pastaj pjesët që ia paraqita
19 dëshmitarit që janë ndër faqet 00391887 deri në 00391936. Ky
20 është materiali i përgjithshëm. Por nga ky material dua që të
21 pranohen faqen nga 00391920 deri në 922. Pra, edhe tre faqe të
22 tjera. Kështu që gjithsej janë katër faqe, faqja e parë dhe
23 këto tre faqe që sapo citova.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit juve.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto tre faqe në
2 anglisht dhe përkthimi i tyre në shqip do të marrin numrin e
3 provës 2D0043. Klasifikimi është konfidencial.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kanë numër
5 provizor provash, pra, thjesht një numër MFI, jo numër prove.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, ju kërkoj ndjesë. E
7 korrigjoj atë çfarë thashë. Pra, do i caktohet numri provizor
8 i provave. Dhe dua të shtoj po ashtu që klasifikimi është
9 konfidencial.

10 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
12 Barthe ka disa pyetje.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
14 Smith.

15 Pyetje nga Trupi Gjykses:

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.
17 Mirëdita, z. Krasniqi.

18 PË. Mirëdita.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses ka disa pyetje
20 të tjera për ju lidhur me disa aspekte të dëshmisë së dhënë
21 përpara nesh ose deklaratës tuaj që sipas mendimit tonë ka
22 nevojë për sqarime të mëtejshme. Është e qartë kjo?

23 PË. E qartë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja e parë
25 është kjo: Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së, pra,

1 Prokurorisë në këtë Gjykatë, po gjithashtu edhe përpara Trupit
2 Gjykses, ju përmendët që z. Fatmir Limaj që ju thatë që e
3 njihnit që prej kohës që keni qenë në Zvicër, pra, a është e
4 saktë që ju e keni njohur z. Limaj që prej kohës kur ishit në
5 Zvicër?

6 PË. Jo, nuk është e saktë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk e keni njohur z. Limaj
8 përpara sesa të takoheshit me të në Kosovë, pra, nuk e keni
9 njohur gjatë kohës që keni qenë në Zvicër?

10 PË. Z. Limaj e kam njohur që nga koha e fëmijërisë sepse jemi
11 të të njëjtit vendbanim dhe kemi pasur dhe njohje
12 ndërpersonale dhe ndërfamiljare.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju e njihnit atë
14 përpara sesa të dy ju të shkonit në Zvicër, është e saktë kjo?

15 PË. Pikërisht. Dhe për të njëjtën kauzë edhe jemi larguar nga
16 Kosova.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Thatë
18 gjithashtu që z. Limaj u bë komandanti i Brigadës 121, pasi të
19 dy ju u kthyet në Kosovë. A është e saktë kjo?

20 PË. Fillimisht ka qenë përgjegjës apo komandant i pikës në
21 Kleçkë para ofensivës së parë. Dhe me rastin e fillimit të
22 ristrukturimit është vendosur apo caktuar komandant i
23 brigadës.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Krasniqi, për
25 procesverbal, kur u bë z. Limaj komandant i Brigadës 121, në

1 cilin vit, në cilin muaj?

2 PË. Bëhet fjalë për vitin 1998. Tani nuk mund të jem i saktë
3 me data apo me muaj. Por me rastin e themelimit të Brigadës
4 121, i pari komandant me emërtimin brigadë ka qenë i caktuar
5 z. Limaj dhe kjo duhet të ketë ndodhur, mendoj, mendoj, nëse
6 s'jam gabim, pak kohë apo menjëherë pas ofensivës së parë. Apo
7 për të qenë më i saktë nga momenti i themelimit të brigadës.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do t'jua bëj përsëri pyetjen
9 për procesverbal këtë pyetje, kur ka ndodhur ofensiva e parë?

10 PË. Sipas meje, sepse edhe kjo çështje e interpretueshme në
11 bazë të zonave operative, në bazë të zonave apo lokalitetet ku
12 kanë vepru njësitet apo pikat e UÇK-së. Sipas meje, ofensiva
13 ka filluar në korrik dhe ka përfunduar diku në fund të muajit
14 gusht, përkatësisht në fillim të muajit shtator.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më korrigjoni nëse e kam
16 gabim, por sipas dëshmisë tuaj, z. Limaj u bë komandant i
17 Brigadës 121 në fund të gushtit, fillim të shtatorit, pas
18 ofensivës, kështu?

19 PË. Po, mirë. Më saktësisht mund të jetë shtatori por nuk
20 mund të jem më konkret se kaq.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Pa problem. Ku
22 qëndronte z. Limaj në kohën kur ishte komandant i Brigadës
23 121?

24 PË. Si komandant brigade ka qëndruar në shtëpinë e Sabit
25 Zogajt në Fshatin e Ri. Do të thotë, pas tërheqjes si

1 komandant pike në Kleçkë, paraprakisht është vendosur po ashtu
2 si komandant pike në këtë shtëpi dhe pas themelimit të
3 brigadës ka vazhduar përsëri në të njëjtën shtëpi në Fshatin e
4 Ri si një lloj komande e Brigadës 121. Do të thotë edhe si
5 pikë ka vepru në atë shtëpi edhe si brigadë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa larg është Fshati i ri
7 nga Kleçka?

8 PË. Po tash varet se cilin pikë e merrni si referencë. Në
9 qoftë se e marrim pikën e komandës së brigadës dhe
10 paraprakisht pikës Çeliku, atëherë mund të jetë rreth 4
11 kilometra apo diçka më pak 3, 4, 3 kilometra e gjysë
12 përfaqësisht.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Më vonë,
14 domethënë, pas fillimit të gushtit ose fillimit të shtatorit,
15 kur z. Limaj u bë komandant i Brigadës 121, ju thatë që z.
16 Haxhi Shala u bë së pari zëvendësi i z. Limaj dhe eventualisht
17 e zëvendësoi z. Limaj dhe u bë komandant i kësaj brigade, a
18 është e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po. Kjo është sipas kujtesës sime, sipas asaj që unë e
20 mbaj mend.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përsëri për procesverbal, e
22 kisha fjalën për paragrafin 88 të Shënimit Përgatitor 1.

23 Z. Krasniqi, do ju bëj këtë pyetje: Kur ka ndodhur kjo
24 ose me fjalë të tjera kur e ka zëvendësuar z. Shala z. Limaj
25 si komandant i Brigadës 121?

1 PË. Sipas kujtesës sime, z. Shala e ka zëvendësuar z. Limaj
2 diku në muajin tetor. Duhet të jetë në muajin tetor 1998.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ku qëndronte z. Shala kur u
4 bë komandant i Brigadës 121?

5 PË. Me aq sa më kujtohet, i nderuar, z. Shala ka qenë jashtë.
6 Ka ardh nga jashtë, nga jashtë vendit. Po flas për periudhën
7 specifike

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Shala a ka qenë i
9 stacionuar gjithashtu në Fshatin e ri si z. Limaj?

10 PË. Po pasi që është caktuar në atë pozicion duhet të jetë
11 caktuar, duhet që të ketë qëndruar aty. Mirëpo duhet të kemi
12 parasysh se pse komanda e brigadës tani mund të futet në atë
13 periudhën ku ka lëvizur me lokacion përsëri në Kleçkë pasi që
14 janë tërhequr forcat serbe, pas Marrëveshjes Milosevic-
15 Holbrooke.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptojmë. Z. Krasniqi, në
17 fakt e thatë edhe më herët, për shembull, e keni thënë në
18 paragrafin 32 të Shënimit Përgatitor numër 1, që z. Limaj u bë
19 pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, pra, u bë anëtarë i Shtabit
20 të Përgjithshëm, a është e saktë kjo?

21 PË. Po. Këtë e kam kuptuar me rastin e caktimit të z. Haxhi
22 Shala komandant brigade. Do të thotë, arsyeja për me e kuptu
23 me kohë një lëvizje të tillë ka qenë emërimi apo caktimi i z.
24 Shala në pozicionin paraprak të z. Limaj.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Përderisa

1 thatë që z. Shala është emëruar në tetor 1998, po z. Limaj a u
2 bë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm po ashtu në tetor 1998,
3 mesa ju kujtohet juve?

4 PË. Jo. Në tetor ishte fjala për z. Shala i cili është
5 caktuar zëvendëskomandant i z. Limaj. Ndërsa në pozitën e
6 komandantit të brigadës, z. Shala duhet të jetë caktuar në
7 muajin nëntor, nëse nuk gaboj, 1998. Mund të ketë qenë mesi,
8 fundi i nëntorit ose ndoshta dhe fillimi i dhjetorit, mirëpo
9 unë besoj se një gjë e tillë ka ndodhur në pjesën e dytë të
10 muajit nëntor.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Çfarë pozite,
12 Prokuroria roli mori z. Limaj në Shtabin e Përgjithshëm, çfarë
13 funksioni apo çfarë roli pati ai në Shtabin e Përgjithshëm?

14 PË. Nga ajo që kam kuptuar atëherë dhe që jemi informuar, ka
15 marrë rolin e drejtorisë së policisë ushtarake.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Krasniqi,
17 kam disa pyetje të tjera lidhur -- atëherë përsërisë edhe një
18 herë, kam disa pyetje të tjera lidhur me rastin Krojmir.

19 Në seancë përgatitore me ZPS-në -- shëndet, Dëshmitar. Në
20 Shënimin Përgatitor numër 1 me ZPS-në, po gjithashtu edhe në
21 dëshminë e dhënë përpara Trupit Gjykses, ju përmendët që z.
22 Rexhep Selimi ka liruar pesë të dyshuar pasi policia ushtarake
23 ose policët ushtarakë dhe ushtarë të tjerë i kishit bërë një
24 përmbledhje të rastit dhe z. Selimi ju kishte përgëzuar ju për
25 punën e bërë, a është e saktë kjo?

1 Më konkretisht për procesverbal i referohem paragrafit
2 101 të Shënimit Përgatitor 1 dhe paragrafit 79 deri në 100 të
3 Shënimit Përgatitor numër 2.

4 PË. Po, plotësisht e saktë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mbrojtja e z. Selimi ju
6 pyeti më herët sot, në qoftë se biseda ose takimi që patët me
7 z. Selimi mund të ketë ndodhur në Divjakë dhe jo në Kleçkë. A
8 ju kujtohet kjo pyetje?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal po i
11 referohem faqeve 6 dhe 7 të transkriptit në kohë reale të
12 ditës së sotme.

13 Ju konfirmuat, z. Krasniqi, që takimi ka ndodhur në
14 Kleçkë aty ku mbaheshin të dyshuarit, a është e saktë kjo?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në fakt, keni thënë në
17 seancën përgatitore, në paragrafin 65 të Shënimit Përgatitor
18 numër 1, që burgu në Kleçkë ishte në pjesën perëndimore të
19 Kleçkës, në kufi me Divjakën, midis shtabit të Shtabit të
20 Përgjithshëm, selisë së Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë
21 edhe Brigadës 121 në Kleçkë, me një distancë afërsisht 1200
22 metra nga njëra pikë tek tjetra, domethënë, nga njëri shtab
23 tek tjetri, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Tash për sa i përket orientimit gjeografik nuk jam aq i
25 mirë, mirëpo është e saktë që qendra e ndalimit në Kleçkë

1 ndodhej përafërsisht në mes të shtabit të brigadës dhe Shtabit
2 të Përgjithshëm.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime
4 është kjo: Në qoftë se e kuptova drejt, pra, z. Selimi erdhi
5 për t'ju takuar ju, nuk shkuat ju për ta takuar z. Selimi, a
6 është e saktë kjo?

7 PË. Po, pikërisht e saktë është. Por nëse mund të shtoj, jo
8 për të më takuar mua personalisht, por për t'u takuar edhe me
9 persona tjerë, siç e kam sqaruar më herët. Do të thotë takim i
10 përbashkët ka qenë. Jo takim vetëm me mua.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E vërtetë. E thatë edhe më
12 herët që të dyshuarit ishin të pranishëm gjatë bisedës që keni
13 pasur me z. Selimi dhe që ata e mbrojtën veten. Kjo është e
14 thënë gjithashtu edhe në paragrafin 101 të Shënimit Përgatitor
15 numër 1. A është e saktë kjo?

16 PË. Po, e saktë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mendoj që kjo
18 është e qartë.

19 Mendoj që është dhe momenti i përshtatshëm për të bërë
20 pushimin.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
22 pushimin e drekës. Mund të dilni nga salla, Dëshmitar. Ju
23 lutem mos flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit për
24 dëshminë përpara nesh. Do kthehemi përsëri këtu në orën 2.30.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
2 pushim deri në 2.30.

3 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

4 --- Seanca rifillon në orën 14.31

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
6 sillni dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, z.
9 Krasniqi, do vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Barthe.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, zoti --
11 Gjykatësi Smith.

12 Dhe mirë se erdhët z. Krasniqi. Para pushimit të drekës
13 po flisnim për bisedën që ke pasur me z. Rexhep Selimi për
14 hetimet në çështjen e Krojmirrit. Dhe unë kam këtë pyetje: z.
15 Selimi gjatë këtij takimi a ju tha ju pse i liroi të
16 dyshuarit?

17 PË. Lirimi i të dyshuarve ka ndodhur në fund të takimit dhe
18 nuk është -- nuk mbaj mend të jenë thënë arsyet e lirimit apo
19 të qëndrimit të tij.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Selimi a ju
21 tha mbi ç'baza, mbi ç'autoritete të liroi të burgosurit apo të
22 dyshuarit?

23 PË. Jo, asnjë lloj shpjegimi apo bisede e kësaj natyre nuk
24 është bërë mesa mbaj mend.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E pyete ti -- ti vetë e

1 pyete me çfarë -- mbi çfarë bazash e mori këtë vendim?

2 PË. Jo, nuk e pyeta sepse siç e thashë dhe më herët, nuk ka
3 ndodhur asnjë rast tjetër të kem pyetje të tilla kur ka vepru
4 dikush më tej.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Krasniqi, sot në faqen 10
6 të transkriptit, ju thatë se nuk keni pasur dijeni të lidhjeve
7 familjare që ka pasur z. Faik Shala me komandantin tuaj të
8 brigadës, z. Haxhi Shala. Ju kujtohet kjo?

9 PË. Po, e saktë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në këtë kontekst do të doja
11 të dija nëse z. Selimi ka thënë gjatë kësaj bisede se mund të
12 ishte i shqetësuar për paanshmëri prej jush apo prej z. Shala
13 sepse kishte lidhje farefisnore apo kishte një lloj lidhje mes
14 një ose më shumë viktimave të pretenduara dhe personit
15 përgjegjës për hetimin. E tha ai diçka të tillë?

16 PË. Nuk mbaj mend ta ketë thënë, dhe nuk besoj ta ketë thënë
17 një gjë të tillë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pse nuk besoni? Pse nuk e
19 besoni diçka të tillë?

20 PË. Sepse po ta thoshte do të duhej ta mbaja mend.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A i thatë ju
22 z. Selimi se nuk e kishit informuar z. Dobruna për këtë rast?

23 PË. Nuk jam i sigurt, por nuk mendoj t'i kem thënë. Nuk jam i
24 sigurt.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në seancë përgatitore me

1 ZPS-në, e përkatësisht në shënimin përgatitor, ju keni thënë
2 se ju personalisht nuk e keni hetuar më rastin, sepse rasti
3 ishte tashmë me Rexhep Selimin, i cili ishte pjesë e Shtabit
4 të Përgjithshëm. A ju kujtohet t'ja keni thënë këtë
5 Prokurorisë?

6 PË. Po, saktë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju besonit se z. Selimi dhe
8 Shtabi i Përgjithshëm do ta hetonin më tej rastin apo do
9 merrnin masa të mëtejshme?

10 PË. Si në këtë rast dhe si në raste të tjera nuk kam shfaqur
11 asnjëherë interes të di rrjedhën e mëtejme të rasteve.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Qartë. Faleminderit. Sipas
13 paragrafit 102 të Shënimit Përgatitor 1, i keni thënë
14 Prokurorisë se nuk besonit se z. Zogaj, si personi përgjegjës
15 për burgun në Kleçkë duhet ta kishte kundërshtuar një kërkesë
16 një anëtar -- një kërkesë që do vinin nga një anëtar tjetër i
17 Shtabit të Përgjithshëm njësoj siç nuk e kundërshtuat ju
18 lirimi që ju bëri z. Selimi të dyshuarve në rastin e
19 Krojmirit? Ja keni thënë këtë Prokurorisë?

20 PË. Po, e saktë dhe e kam pasur fjalën në kontekstin praktik
21 të rasteve siç më është vepruar atëherë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 96 të Shënimit
23 Përgatitor 2, ju keni thënë:

24 "Dëshmitari W04743", që jeni ju z. Krasniqi, "tha, se kur
25 u dorëzua dosja, Dëshmitari W04743 këtë punë të përfunduar dhe

1 këtë dosje në duart e autoritetit epror, pra, të Shtabit të
2 Përgjithshëm, pasi të gjithë -- pasi dhe ai vetë edhe ushtarët
3 e tjerë e njihnin mirë rolin e Rexhep Selimit, e dinin çfarë
4 roli kishte Rexhep Selimi.”

5 Z. Krasniqi, a ju kujtohet ta keni thënë këtë në seancën
6 përgatitore me Prokurorinë?

7 PË. Po, saktë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni atëherë
9 dhe një herë ju lutem, çfarë roli apo funksioni kishte z.
10 Selimi pranë Shtabit të Përgjithshëm?

11 PË. Sipas asaj që dija unë dhe të tjerët në Brigadën 121,
12 roli i z. Selimi ishte Inspektor Gjeneral i UÇK-së.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, sipas jush, z. Selimi
14 ishte në një pozicion më të lartë nga ai që kishit ju, siç
15 është thënë sot kjo në transkriptin e ditës së sotme në faqen
16 18. Pra ju keni thënë, ai ka qenë autoritet superior, epror,
17 saktë?

18 PË. Sigurisht, në raport me mua dhe të tjerët rreth meje,
19 natyrisht që ishte.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Krasniqi, në një
21 përgjigje të avokatit të z. Selimi, ju thatë që në ato
22 rrethana, z. Selimi po bënte gjënë e duhur duke i liruar këta
23 të dyshuar. Dhe kjo gjendet në faqen 18 të transkriptit të
24 ditës së sotme. A mund të na thoni pse mendonit ju që kishte
25 të drejtë z. Selimi që po i lironte të dyshuarit?

1 PË. Tash nëse më duhet ta parafrazoj vetveten, duhet të kem
2 thënë, dhe mendoj të kem thënë, se z. Selimi mund të ketë bërë
3 gjënë e duhur. Unë po dëshmoj një të vërtetë të paanshme, të
4 qartë dhe të saktë. Tani për ta vlerësuar veprimin e tij
5 mendoj se nuk jam unë kompetent.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Gjithashtu
7 përmendët dhe rastin e një të ndaluari me emrat [REDAKTUAR],
8 të cilin e ka dorëzuar Agim Çeku, shefi i Shtabit të
9 Përgjithshëm të UÇK-së. A ju kujtohet kjo? Si të jesh
10 trajtuar, më falni. Është trajtuar.

11 PË. Do të thotë, rasti i [REDAKTUAR] është vendosur nga z.
12 Agim Çeku, atëherë shef i Shtabit të Përgjithshëm, mirëpo këtë
13 fakt e kam mësuar gjatë rastit Kleçka.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A është e
15 vërtetë që z. Çeku e dënoi [REDAKTUAR] me 25 vjet burgim -- më
16 falni, ditë?

17 PË. Është e vërtetë, bazuar në shkresat e lëndës të rastit
18 Kleçka, që mendoj duhet të jetë edhe në shkresat e lëndës tani
19 të Prokurores.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po duke qenë se z. Çeku nuk
21 ishte as gjykatës as prokuror, në çfarë cilësie e trajtoi ai
22 këtë rast? Ju thatë që ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm i
23 UÇK-së. Në këtë cilësi vendosi për këtë rast?

24 PË. Tani mendimi im është sepse një veprim i tillë mund të
25 jetë bërë nga ai në mungesë të z. Dobruna. Për më tej mendoj

1 se -- nuk e di a mund ta shtjelloj, a mund të jap ndonjë
2 informacion të dobishëm për Gjykatën.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Krasniqi,
4 ju, njësoj si z. Zogaj, nuk mund t'i kundërshtonit këto
5 vendime për shkak të rolit apo pozicionit që kishte z. Çeku
6 pranë Shtabit të Përgjithshëm. Kam të drejtë?
7 PË. Nëse më lejoni, mendoj se mund të ndërliidhen me një
8 përgjigje që ja dhashë avokatit të z. Selimi sot paradite. Kjo
9 nuk do të thotë se brenda UÇK-së nuk kishte edhe veprime
10 kundërshtuese ose individë që mund të kenë kundërshtuar, që
11 tani nuk mund të jem specifik me raste. Çështja e zbatimit të
12 vendimeve ose të urdhrave, e thashë edhe më herët, se lidhet
13 edhe me çështjen e ndërgjegjshmërisë, përgjegjshmërisë dhe
14 besimit në UÇK-në dhe besimit në Shtabin e Përgjithshëm. Mua
15 më shumë më kanë udhëhequr parime morale e njerëzore, sepse në
16 atë periudhë, e kam thënë, nuk kam qenë njohës i ligjit dhe
17 nuk kam pasur asnjë lloj eksperience me natyrën e punëve të
18 tilla.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Krasniqi.
20 Nuk kam më pyetje të tjera.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
22 Mettraux tani.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit dhe mirëdita,
24 Dëshmitar.

25 PË. Mirëdita.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshiroj t'ju pyes
2 fillimisht për një person që ja keni përmendur ZPS-së, z.
3 Jashar Salihu. Fillimisht a mund të na thoni kush është ky
4 person? Të konfirmoni që e njihni, po.
5 PË. Jashar Salihu, tani i ndjerë, ka ndërruar jetë pas
6 luftës, e kam njohur si figurë e rëndësishme e Lëvizjes
7 Popullore të Kosovës në Zvicër, por jo njohje nga afër. E kam
8 njohur si një person të rëndësishëm e të respektueshëm, i cili
9 ka dhënë kontribut të çmuar për lirinë dhe shtetësinë e vendit
10 dhe njëkohësisht ka qenë kryetar i Fondit Vendlindja Thërret.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Në fakt, iu
12 përgjigjët pesë prej pyetjeve të mia me këtë përgjigje. Kur
13 thoni ishte një figurë e spikatur apo e njohur e Lëvizjes
14 Popullore të Kosovës, e keni fjalën për LPK-në?

15 PË. Po, pikërisht.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju po ashtu sapo
17 thatë, z. Salihu ka vdekur, ka vdekur pas luftës. Ju keni
18 thënë me përafërsi në cilin vit ka vdekur?

19 PË. Nuk e di saktësisht, por në vitet e para të pas luftës ka
20 ndërruar jetë nga një sëmundje e rëndë, por që nuk kam pasur
21 ndonjë njohje nga afër me të, por e njoh si figurë e
22 rëndësishme edhe si një veprimtar i çështjes kombëtare.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sapo thatë në një
24 përgjigjen tuaj që ju keni menduar se ai ka qenë kryetari i
25 Fondit Mëmëdheu Thërret, apo jo?

1 PË. Po, Vendlindja Thërret. Së paku kështu unë e kam ditur.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të themi se një nga
3 qëllimet e këtij Fondi Vendlindja Thërret ishte të ndihmonte
4 përpjekjet e UÇK-së për luftë, saktë?

5 PË. Unë mendoj jo një ndër qëllimet, por qëllimi bazë duhet
6 të ketë qenë financimi i luftës çlirimtare që po fillonte apo
7 siç kishte filluar në Kosovë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, z. Salihu apo Fondi
9 Vendlindja Thërret kanë qenë, kanë paguar edhe bilën tuaj për
10 t'u ktyer në Kosovë, apo jo?

11 PË. Po, pikërisht z. Salihu më ka pritur në aeroportin e
12 Cyhirit dhe aty jemi takuar për të ma dhënë biletën dhe disa
13 gjësende që do të duhej t'i merrja me vete për në Kosovë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përveç këtij funksioni si
15 kryetar, drejtues i Fondit Vendlindja Thërret, mesa dini ju,
16 z. Salihu ka ushtruar ndonjë funksion tjetër brenda UÇK-së?

17 PË. Nuk e di, nuk jam i sigurt.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I keni thënë diçka
19 Prokurori gjatë seancës përgatitore, është Shënimi Përgatitor
20 numër 2, paragrafi 6.

21 A ju kujtohet që i keni treguar Prokurorisë procesin që u
22 ndoq se si u bëtë ju anëtar i LPS-së, z. Krasniqi? A ju
23 kujtohet ta keni diskutuar këtë?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse keni nevojë ta

1 shikoni shënimin përgatitor mund të më thoni, po unë po ju bë
2 fillimisht pyetjen. A ju kujtohet se ju shpjeguat dhe thatë që
3 në mënyrë që dikush të bëhej anëtar i LPK-së dikush -- duhet
4 të ishte dikush në Lëvizje që të dilte garant për ju ose t'ju
5 rekomandonte dikush që ishte pjesë e fondit. A ju kujtohet ta
6 keni thënë këtë?

7 PË. Po, këto kanë qenë procedurat që kanë funksionuar brenda
8 vendit deri në dhënie të betimeve, gjë që unë nuk e kam
9 aplikuar, sepse kontakti i vetëm i vogël i imi ka qenë përmes
10 z. Ragip Shala, po ashtu vendas i imi. Dhe në një formë, ky
11 mund të ketë qenë një lloj garancioni, por mbi të gjitha ai
12 filtri i verifikimit përveç kësaj mund të nënkuptohej se është
13 tejkaluar ose kaluar me rastin e tentimit të forcave të serbe
14 që të na arrestojnë, për shkak se në fund të vitit '96 tashmë
15 teorikisht jo dhe praktikisht ishim pjesë s UÇK-së unë përmes
16 Fatmir Limës kam qenë pjesë e UÇK-së, ndërsa njohjen me LPK-në
17 përmes Ragip Shalës. Ndërsa formalisht anëtar i LPK-së, jam
18 bërë në Zvicër në Vintertor [Siç u dëgjuar] nga personat që i
19 kam cekur në deklaratë, nga Xhavit Hoxha, Sejdi Gegaj dhe
20 Shefik Bajraktari. Ka pas edhe persona të tjerë që nuk më
21 kujtohen emrat.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse e kuptoj unë drejt,
23 Ragip, Ragip - më falni - Ragip Shala ka qenë personi që doli
24 garant për ju, apo jo?

25 PË. Përmes Ragip Shalës është, është kontakti i parë dhe

1 depërtimi në LPK, nëse mund ta quaj ashtu. Mirëpo,
2 shprehimisht nuk mendoj t'i kërkuar dikush një garancion
3 ekstra të veçantë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ragip Shala, a është
5 kushëri me Fatmir Limajt?

6 PË. Nuk mund të them kushëri, por të të njëjtit fshat, sepse
7 kanë mbiemra të ndryshëm dhe janë lagje të ndryshme.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Meqë po flasim për
9 familjen Shala, po Haxhi Shala, a është i afërm i Fatmir
10 Limajt mesa dini ju?

11 PË. Haxhi Shala është nip i lagjes së Fatmir Limajt, por jo
12 direkt i Fatmir Limajt.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Flasim për LPK-në sërish.
14 Nëse mundeni, ju lutem, na e shpjegoni pse ishte e rëndësishme
15 për LPK-në që të kishte këtë proces filtrimi apo vetingu që ta
16 dinte se kush do të bëhej anëtar i Lëvizjes?

17 PË. Këto janë procedura të cilat i kam mësuar nga z. Ragip
18 Shala, kur e përmenda edhe procesin e vetimit që paskan
19 aplikuar në disa rast, por që z. Ragiç Shala nuk e ka aplikuar
20 një gjë të tillë për shkak të sigurisë. Do të thotë ai është
21 ndi më i sigurtë me qëndru në rrethe të ngushta, dhe mos me i
22 apliku disa procedura të kohës ilegale në Kosovë, për shkak të
23 dekonspirimeve të mundshme.

24 Do të thotë disa procedura që janë zbatuar sipas Shalës,
25 ky vetë nuk i ka ndjekur për çështje sigurie, sepse shumë herë

1 informacioni ka pas dekonspirim të informacioneve.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo në fakt do të
3 ishte pyetja ime e radhës. Këto procedurat që duhet të duhet
4 të kalonte z. Shala, ishte për shkak të frikës se mund të
5 kishte infiltrim në Lëvizje nga persona të padëshirueshëm. E
6 thënë ndryshe, nga persona që mund t'u jepnin informata
7 autoriteteve jugosllave, saktë?

8 PË. Ky ka qenë vlerësimi dhe gjykimi i tij.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini kush ka qenë
10 përgjegjës në LPK për filtrimin apo kontrollin e këtyre
11 personave?

12 PË. Jo, nuk e di.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po kush ka qenë përgjegjës
14 për të hetuar këto rrjedhje të informacionit që përmendët ju?

15 PË. Nuk e njoh në këto detaje organizimin për të mundur të
16 jap përgjigje. Do të thotë thjesht nuk e di.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do t'ju pyes për disa
18 raste që i keni përmendur, në fakt, ja keni përmendur kolegut
19 tim, Gjykatësit Barthe edhe avokatëve këtu. Por, fillimisht do
20 t'ju bëj disa pyetje të përgjithshme.

21 A e kam kuptuar drejtë unë që rastet shtatë, a nëntë
22 rastet që keni trajtuar ju, ishin të gjitha raste të zonës
23 suaj të përgjegjësisë, pra që ishin pjesë e përgjegjësisë së
24 Brigadës 121?

25 PË. E kam theksuar edhe tek ZPS-ja se gjithsej në dosje janë

1 dhjetë raste, nga dhjetë rastet është ai rasti i Sedllarit që
2 është një procesverbal i përpiluar në atë rast në marrjen në
3 pyetje nga z. Dobruna, i cili na ka ndihmuar dhe na ka mësuar
4 sesi do të duhej të bëheshin ato veprime, dhe tani mbesin
5 nëntë kallëzime penale. Nëntë raste praktisht, nën kallëzime
6 penale. Nga këto raste nëntë raste, dy raste janë ku i kemi
7 përgatitur në fillim së bashku me z. Nexhmi Krasniqi në kuadër
8 të Brigadës 121. Katër raste mandej janë, që janë përgatitur
9 nga unë dhe --

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju ndalova sepse besoj që
11 nuk e bëra të saktë pyetjen. Mua më intereson kjo: Nga
12 pikëpamja gjeografike, rastet që keni trajtuar ju, ishin raste
13 apo incidente që kishin ndodhur brenda territorit të Brigadës
14 121, saktë?

15 PË. Faleminderit për sqarimin. Po, saktë. Nëntë raste janë që
16 kanë ndodhur në territorin e Brigadës 121.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është një rast, për
18 shembull, që do ta le për një moment mënjanë po do flasim
19 prapë. Sa prej këtyre rasteve lidheshin me pretendime për
20 keqtrajtim apo vrase të personave të dyshuar si
21 kolaboracionistë, nëse ka pasur ndonjë rast të tillë?

22 PË. Të lutem me përsëritni këtë mundësisht.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. E kam fjalën në lëndën
24 e asaj që hetohet natyra e shkeljeve që kishin ndodhur dhe që
25 hetonit ju, a ishte ndonjë nga këto rastet lidhur me ndonjë

1 vrasje apo keqtrajttime të ndonjë personi që dyshohej si
2 kolaboracionist -- në mesin e UÇK-së, më falni.
3 PË. Nuk e di nëse jam duke e kuptuar qartë pyetjen për
4 kolaboracionizëm është dërguar në Bellanicë z. Sylejman
5 Ramadani, mendoj, nëse nuk e kam gabim. Mirëpo, i cili në
6 mëngjes është liruar sepse nuk ka pasur asnjë bazë për të
7 qëndruar më tutje. Madje --

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përsëri e marr unë
9 përsipër fajin që nuk isha shumë i qartë në pyetjen time. Nuk
10 po ju pyes për raste ku objekt i hetimeve kur, për shembull,
11 z. Sabit Shala ose Ramadani, janë pretenduar se kanë qenë
12 bashkëpunëtorë, por unë po ju pyes në qoftë se keni hetuar
13 ndonjë pjesëtar të UÇK-së për arsye se personi në djalë
14 pretendohej që ose ndoshta kishte vrarë ose kishte keqtrajtuar
15 një bashkëpunëtor ose kolaboracionist të dyshuar. Për këtë po
16 ju pyes.

17 PË. Tani e kam pyetjen plotësisht të qartë, mendoj. Një gjë e
18 tillë nuk ka ndodhur asnjëherë sepse ne jemi marrë ose kemi
19 trajtuar situata ose raste emergjente të cilat janë paraqitur
20 ose kanë ndodhur dhe asnjë rast i tillë nuk ka pasur mundësi
21 të trajtohet për shkak se nuk kemi pasur as kapacitete e as
22 hapësirë kohore, dhe asnjë kërkesë të tillë. Mendoj që kanë
23 mungu plotësisht resurset për një hetim të tillë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani do t'ju
25 pyes për rastin e Krojmirrit. Kam disa pyetje lidhur me këtë

1 rast.

2 Mënyra se si e kuptoj unë rastin dhe në qoftë se nuk e
3 kuptoj siç duhet ju lutem më korrigjoni, por mënyrë se si e
4 kuptoj unë rastin është që katër oficerët e policisë ushtarake
5 që u arrestuan fillimisht për shkak se kishin krijuar një
6 ambient për ndalim dhe kishin ndaluar pa autorizimin e
7 eprorëve të tyre. Domethënë, kjo është fabula. A është e saktë
8 kjo, Dëshmitar? A kishte të bënte incidenti i Krojmirit me
9 këtë që sapo ju shpjegova?

10 PË. Po. Incidenti i Krojmirit kishte të bënte me një qendër
11 ndalimi në fshatin Pjetërshticë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e kuptoj drejt, të
13 paktën sipas fushave tuaja të përgjegjësisë -- në fushën tuaj
14 të përgjegjësisë një grup i policisë ushtarake të UÇK-së nuk
15 kishte kompetencën ose autoritetin që të krijonte një vend
16 ndalimi dhe të ndalonte njerëzit aty, dhe për këtë arsye në
17 raportin tuaj ju keni thënë specifikisht që ata kanë vepruar
18 pa njohurinë e autoriteteve më të larta ose të hierarkisë më
19 të lartë. A është e kjo, Dëshmitar?

20 PË. E saktë plotësisht.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes edhe për
22 diçka tjetër për të kuptuar që e kam -- për t'u siguruar që e
23 kam kuptuar siç duhet dëshminë tuaj. Në një rast ose në një
24 hetim që e përshkuat juve mund të zhvillohej ose mund të vihej
25 në lëvizje në një prej dy mënyrave të veçanta. Pra, njëra prej

1 këtyre mënyrave ishte që të depozitohej një raport penal për
2 policinë ushtarake përpara z. Dobruna. A është e saktë kjo?
3 Pra, kjo ishte një prej mënyrave për të bërë hetime.

4 PË. Kur ne e kemi deponuar kallëzimin penal tek z. Dobruna,
5 aty dhe ka përfunduar puna jonë. Ne nuk e kemi vazhduar
6 procedurën më tutje. Më tutje mund të jetë marrë z. Dobruna,
7 mirëpo nuk mund të flas me saktësi më tutje.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Megjithatë, ky do ishte
9 veprimi që do e kishte vënë në lëvizje përgjegjësinë e tij.
10 Domethënë, që z. Dobruna të vazhdonte dhe të ushtronte
11 funksionet e veta, apo jo? Pajtoheni me këtë?

12 PË. Unë pajtohem dhe këtë veprim unë dhe stafi im e kemi
13 pikërisht bazuar në rekomandimet e z. Dobruna. Rekomandime dhe
14 udhëzime të z. Dobruna, lidhur me procedurat që na i ka thënë
15 në mënyrë verbale, sepse të shkruara nuk i kemi pasur
16 asnjëherë. Do të thotë, kështu ka qenë udhëzimi që puna jonë
17 përfundonte me rastin e dorëzimit të kallëzimit penal, me
18 rastin e dorëzimit të çështjes.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë e kuptova që ju thatë
20 që z. Dobruna mund të vepronte gjithashtu edhe proprio motu,
21 domethënë me iniciativën e vet, me nismën e vet, për shembull,
22 që të lëshonte një urdhër arresti siç ka bërë në rastin e
23 Sabit Shalës ose babait të tij Habibit. A është e saktë kjo,
24 Dëshmitar?

25 PË. Unë kam fol dhe po flas në bazë të këtyre që kanë ndodhur

1 jo se unë i kam parë të shkruara kompetencat e z. Dobruna dhe
2 kompetencat e stafit tjerë të nivelit qendror, apo që i kam
3 ditur me saktësi.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj.

5 Le të shohim provën 2D20.

6 Tani do t'ju tregoj një dokument, Dëshmitar. Është një
7 dokument të cilin e keni parë disa herë deri tani. Është
8 procesverbal ose një pjesë e procesverbalit për rastin e Sabit
9 Shalës. Do ju tregoj dokumentin dhe do ju pyes pastaj lidhur
10 me një sqarim që dua të më bëni.

11 Së pari, a ju kujtohet që e keni parë më herët këtë
12 dokument?

13 PË. Po, sigurisht.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa për procesverbal data
15 është 20 mars 1999. Që është thujse tre javë pasi ju jeni
16 emëruar si drejtuesi i ZKZ-së brenda brigadës. A është e saktë
17 kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po, saktë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Dixon ju lexoi një
20 fjali diku nga mesi i tekstit, i këtij dokumenti. Do t'jua
21 lexoj dhe një herë për procesverbal. Thuhet që:

22 "I akuzuari ka kryer në vazhdimësi këto vepra penale duke
23 filluar nga gushti i vitit 1998 e në vazhdimësi deri në ditën
24 e arrestimit.

25 "Këtë e dëshmojnë deklaratat e dhëna nga i akuzuari dhe

1 të dhënat e shërbimit informativ të UÇK-së.”

2 Atëherë po të shikojmë këtë pjesën që ka bërë me të
3 dhënat e Shërbimit Informativ të UÇK-së, kjo ka të bërë me të
4 dhëna ose raporte të cilat ju personalisht keni hartuar apo ka
5 të bërë me raporte apo të dhëna dorëzuara nga të tjerët?

6 PË. Ka të bërë vetëm me informacionet e dorëzuara ose të
7 përcjellura nga bashkëpunëtori im, z. Baftiu.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse ju kuptoj drejt, këtu
9 pasqyrohet aktiviteti juaj në atë kohë, domethënë si oficer i
10 ZKZ-së që keni mbledhur informacion për Sabit Shalën që
11 dyshohet si kolaboracionist. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. I njëjti aktivitet do të bëhet me apo pa ZKZ-në. Është
13 përmendur ZKZ-ja meqenëse kam qenë i caktuar edhe në atë
14 sektor, dhe sa për ta mbajtur gjallë në kuptimin teorik. Do të
15 thotë i njëjti informacion do të sigurohet edhe pa ZKZ-në.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë do ndodhte me këto
17 raporte që hartoheshin nga Shërbimi Informativ i UÇK-së për
18 persona që dyshoheshin si kolaboracionistë? Çfarë ndodhte me
19 raporte të tilla, me informacione të tilla, i arkivonit, ja
20 përcillnit komandantit të brigadës? Çfarë ndodhte me to?

21 PË. Siç e kam cekur, i nderuar Gjyqtar, këtu janë disa
22 informacione që pak a shumë kanë korresponduar me indiciet apo
23 me informatat e para që i kam pranuar nga z. Dobruna, dhe
24 përveç kësaj i njëjti person ka sjellur informacione edhe për
25 rastin e Krojmirit dhe nuk ka rast tjetër. Mirëpo, qoftë këto

1 informata apo ndonjë informatë tjetër eventuale i cili ka
2 mundur të sjellë, të njëjtat nëse janë pa të vlefshme janë
3 përcjellur në brigadë tek komandanti i brigadës. Por që nuk
4 mbaj mend ndonjë informacion të rëndësishëm për ta veçuar apo
5 për ta ndarë këtë me ju.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani dua
7 t'ju pyes lidhur me një rast tjetër. Rastin e Osman Korpuzit.
8 A ju kujtohet ky rast, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini në qoftë se ai ka
11 qenë nga Sedllara ose nga Shala?

12 PË. Në bazë të mbiemrit, ai ka qenë nga fshati Sedllarë apo
13 Shallë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini se çfarë nofke ka
15 pasur ai? Mbase nuk e di në qoftë se keni dëgjuar këtë nofkën
16 Kinezi?

17 PË. E saktë. E kam dëgjuar dhe është e saktë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa kuptova unë dhe prapë
19 në qoftë se nuk e kam kuptuar siç duhet më korrigjoni, ju nuk
20 e dini se çfarë i ka ndodhur z. Korpuzi kur -- në momentin --
21 pasi ai është ndaluar në Kleçkë? A e kam kuptuar drejtë këtë,
22 Dëshmitar?

23 PË. Ai duhet të jetë ndaluar në pjesën e Sedllarit, matanë,
24 tutje duhet të jetë ndaluar dhe të jetë dërguar në Kleçkë.
25 Mandej nuk e di rrethanat se si jam informuar. Ja kam marrë

1 një deklaratë, kam përgatitur kallëzimin penal dhe ai
2 dokumentacion që ka ekzistuar atëherë i është bashkëngjitur
3 kallëzimit penal dhe është dorëzuar tek Sokol Dobruna apo tek
4 prokurori ushtarak, z. Haki Kryeziu. Në këtë rast mbaj mend të
5 jetë dorëzuar tek z. Dobruna, sepse së bashku me lëndën i
6 është dorëzuar edhe *corpus delicti*, domethënë pistoleta me të
7 cilën ka kryer një plagosje, me sa mbaj mend.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e njihni një person me
9 emrin Shkëlzen Ahmeti?

10 PË. Së paku nga emri nuk më kujton që e njoh. Nuk më kujtohet
11 që e njoh.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Adem Imerin, a e njihni
13 një person me të këtë emër?

14 PË. Jo.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Idriz Zekën, a e njihni?

16 PË. Jo.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po dikën me emrin ose
18 nofkën Arben Sejdiu, a njihni ndokënd me këtë emër ose këtë
19 nofkë?

20 PË. Jo.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka dhe një rast të fundit
22 për të cilin do të dua t'ju pyes. Bëhet fjalë për rastin e
23 [REDAKTUAR]. Gjatë seancës përgatitore ose më konkretisht në
24 shënimin përgatitor 2, paragrafi 49, ju keni thënë se ai u
25 dërgua në Kleçkë nga Sheremet Thaçi dhe Osman Hoxha. A ju

1 kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni nga e
4 dini ju këtë?

5 PË. E di sepse ma ka thënë vetë Osman Hoxha.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam
7 pyetje për ju të tjera, Dëshmitar.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
9 Gaynor.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, faleminderit, Gjykatësi
11 Smith.

12 Mirëdita, Dëshmitar. Sa i takon z. Ramadani mendoj që na
13 keni thënë, keni thënë dje se:

14 "Me atë çfarë më kanë thënë në atë kohë dhe ajo çfarë
15 përmbajnë dokumentet është që ekzistonte dyshimi i pabazuar
16 për të që ishte kolaboracionist, çfarë do të thotë që nuk
17 kishte asnjë lloj prove që neve të na bëhej e mundur që të
18 vazhdonim dhe të procedonim më tej me të."

19 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

20 PY. Po, saktësisht.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si çështje e përgjithshme,
22 në brigadën tuaj çfarë ka bërë policia ushtarake për të
23 përcaktuar në qoftë se kishte bazë faktike në rastin e
24 kolaboracionistëve të dyshuar, domethënë me fjalë të tjera
25 çfarë hapash bënit juve në mënyrë që të përcaktonit në qoftë

1 se kishte shkaqe që dikush të konsiderohej si kolaboracionist?
2 PË. Nuk ka pasur një procedurë standarde, siç ia kam thekuar
3 edhe Prokurorisë. Secili rast dallon nga rasti tjetër. Çdo
4 rast ka qenë emergjencë që është iniciu nga dikush dhe krejt
5 çfarë kemi bërë, kemi shikuar kemi -- prova të cilat i ka
6 deponuar personi që ka iniciuar dhe në rastin konkret thjesht
7 nuk ka pasur asnjë provë në të cilën kemi mundur të bazohemi.
8 Do të thotë nuk kemi pas mekanizma dhe mundësi të tjera për të
9 hulumtuar më tutje por jemi bazuar ç'ka kemi para vetes në ato
10 rrethana dhe në ato momente. Ne nuk kemi pasur kushte dhe as
11 mundësi që ta mbajmë personin dhe të hulumtojmë më tutje. Nuk
12 kemi pasur mundësi. Mirëpo, dhe në rastin konkret kam bërë një
13 konsultë sa herë që kam pas dilemat se si duhet të veprojmë ose
14 kur nuk kam ditur sesi duhet të veprojmë, atëherë e kam
15 konsultuar z. Dobruna. E kam pas adresë Sokol Dobrunën.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Por si praktikë e
17 përgjithshme, a ekzistonte praktika e marrjes në pyetje të
18 kolaboracionistëve të dyshuar në mënyrë të tillë që të
19 dëgjonin se çfarë qëndrimin kishin ata ose çfarë mendonin ata
20 në kundërpërgjigje të dyshimeve ndaj tyre si kolaboracionistë?
21 PË. Nuk ka ekzistuar një praktikë e tij përveç rasteve kur
22 dikush e ka iniciuar rastin. Nuk ka ekzistuar një praktikë që
23 ne duhet t'i hulumtojmë dhe të merremi. Kjo nuk ka ndodhur në
24 asnjë rast përveç kur e ka inicuar dikush. Do të thotë qoftë
25 rasti Shala, qoftë rasti Ramadani apo dhe një rast tjetër mund

1 të jetë. Janë raste kur i ka inciuar dikush, jo që kemi pasur
2 mundësi, hapësirë kohore dhe profesionale që ne të marrmi
3 iniciativa të lira për të hulumtuar ose për të hartuar
4 evidenca se kush janë ata ose ku janë ata. Së paku në punën
5 time nuk kam parë asnjëherë asnjë lloj evidence me emra të
6 tillë. Asnjëherë nuk ka ndodh në gjë e tillë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në shumë prej dokumenteve që
8 kemi parë, kemi vërejtur që ka pasur kopje të dokumente të
9 krijuara nga Brigada 121. Ne mendojmë që janë bërë kopje për
10 arkivën. Ku është mbajtur kjo arkiva?

11 PË. Të jem i singertë, nuk e kam këtë informacion, sepse ne
12 çdo dokument apo raport që kemi pasur e kemi dorëzuar në
13 brigadë dhe nuk e di mandej se si ka operu brigada dhe ku e ka
14 mbajt atë lloj arkive në qoftë se e ka mbajtur. Do të thotë
15 nuk e kam këtë lloj informacioni. Nuk e di.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje për ju të
17 tjera, Dëshmitar. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka pyetje
19 plotësuese nga Prokuroria mbështetur në pyetjet e Gjykatësve?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts, a
22 keni pyetje plotësuese.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund të më lejoni pak minuta që
24 të konsultohem me klientin përpara se të vazhdojmë më tej?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të

1 konsultoheni.

2 [Mbrojtësi i Specializuar këshillohet]

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
4 nuk kemi pyetje të tjera neve.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon,
6 keni pyetje të tjera?

7 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po, kam pak
8 pyetje për dëshmitar. Nuk do ju marr shumë kohë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem.

10 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

11 Z. DIXON: [Përkthim]

12 PY. Z. Krasniqi, kam edhe disa edhe pyetje të tjera të cilat
13 rrjedhin nga pyetjet që ju bënë Gjykatësit.

14 Së pari, sa i takon një pyetjeje që ju bëri Gjykatësi
15 Barthe. Për procesverbal kjo përmendët në faqen 85. Ju iu
16 bëhet pyetje lidhur me veten tuaj edhe z. Agim Zogaj dhe
17 pyetja që ju bë është në qoftë se mund të kundërshtohet një
18 kërkesë e bërë nga një anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Pra,
19 në qoftë se ju mund të kundërshtonit një kërkesë të bërë nga
20 një anëtar i Shtabit të Përgjithshëm? A ju kujtohet kjo
21 pyetje, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Është e saktë, apo jo, të thuhet se sa i takon z. Zogaj
24 ju nuk e dini, nuk jeni në dijeni të ndonjë kërkesë që i është
25 bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një anëtar i Shtabit të

1 Përgjithshëm. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. E saktë.

3 PY. Sa i takon një pyetje që ja u bëri Gjykatësi Mettraux
4 lidhur me një dokument.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk është e nevojshme që ta shfaqin
6 dhe një herë në ekran këtë dokument

7 PY. Por, është pyetje që ka të bëjë me dokumentin që e keni
8 nënshkruar ju në cilësinë tuaj si komandant i policisë
9 ushtarake të togës së policës ushtarake që është dokumenti i
10 20 marsit 1999. Juve u pyetët lidhur me atë rreshtin që kishte
11 të bënte me Shërbimin e Informativ të UÇK-së dhe të dhënat e
12 këtij shërbimit ose raportet e këtij shërbimi. A ju kujtohet
13 kjo pyetje, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është dokumenti 2D20, nëse
16 ju ndihmon.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk do kërkoj që ta praqes në ekran.
18 Nuk do e kërkoj që ta shikojmë këtë dokument se e pamë pak më
19 përpara. Megjithatë, për procesverbal është dokumenti 2D20.

20 PY. A ju kujtohet që ju bë kjo pyetje pak më herët,
21 Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Në rregull. Ajo çfarë dua të sqaroj me ju është kjo, në
24 dëshminë që keni dhënë më herët sot, dhe për procesverbal këtë
25 e keni thënë në faqen 41, ju thatë se dëshironi që të sqaroni

1 në çështje lidhur me këtë dokument dhe thatë si më poshtë:

2 "... periudha e kohës për të cilën po flasim, në atë
3 periudhë nuk kishte një shërbim informativ *de facto*. Kjo
4 bazohej në informacionin që iu përcillej -- që përcillej nga
5 Baftiu i cili kishte qenë bashkëpunëtor edhe përpara sesa të
6 mbërritja unë, ose para sesa të emërohesha unë aty. Dhe në
7 vend që të përcaktonim këtë informacion që vinte nga një
8 bashkëpunëtor, ne thamë, në vend që -- pra, në vend që të
9 thonim që ky informacion ka ardhur nga një bashkëpunëtor, ne
10 kemi thënë që informacioni ka ardhur nga shërbimi i
11 inteligjencës.

12 "Por, megjithatë, kur flitet për shërbimin informativ,
13 kjo është një çështje kontraktidore sepse në atë kohë nuk ka
14 ekzistuar një shërbim i tillë."

15 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 PY. Atëherë, kjo që keni përmendur ju në raportin e datës 20
18 mars 1999, "Të dhënat ose raportet e Shërbimit Inteligjent të
19 UÇK-së" është konstatim i gabuar ose i pasaktë, në kuptimin që
20 në atë kohë nuk ka pasur një shërbim të tillë, dhe ju nuk kemi
21 pasur të dhëna të tilla prej atij shërbimi ku mbi të cilat
22 juve i nxirrni konstatimet tuaja?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtojmë. Është pyetje e
24 përbërë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ishte e

1 përbërë. Ju lutem, ndajeni në pjesë.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

3 PY. Kur ju thoni këtu që "Të dhënat e Shërbimit Informativ të
4 UÇK-së" në këtë dokument, atëherë së pari, Dëshmitar, nuk ka
5 pasur një shërbim të tillë në atë kohë, apo jo?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkon përtej fushës së veprimit.
7 Është trajtuar në pyetjet e bëra prej ekipeve të Mbrojtjes.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk mendoj që
9 u ngrit kjo çështje.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Gjykatësi Mettraux konkretisht tha
11 që këto ishin raporte nga bashkëpunëtorët e Shërbimit
12 Informativ.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, keni të
14 drejtë.

15 Z. DIXON: [Përkthim]

16 PY. Doni që t'ja u përsëris dhe një herë pyetjen, Dëshmitar?
17 Atëherë në atë kohë me 20 mars 1999, nuk ka ekzistuar një
18 shërbim informativ i UÇK-së, apo jo? A është e saktë kjo,
19 Dëshmitar?

20 PË. Unë e deklarova dhe ma herët, me aq sa unë e di Shërbimi
21 Informativ është formuar pas formimit të Qeverisë së
22 Përkohshme. Mirëpo, thirrja ime në atë dokument që keni para
23 vetes në kallëzimin penal, në fund të fundit, bazohet edhe në
24 emërimin nga brigada që më është bërë. Do të thotë, edhe vetë
25 emërimi nga brigada që më është bërë është në vetvete

1 kontradiktor. Mandej ajo kontradiktë është përcjellë edhe më
2 tutje.

3 E kam sqaruar edhe pjesën shtesë se unë mendoj që iu
4 është referuar ZKZ-së dhe ashtu është vepruar, sepse nuk kam
5 dëgjuar në atë periudhë kohore që dhe në brigada të tjera të
6 jenë quajtur shërbim informativ, përveçse ZKZ. Mirëpo, për mua
7 në ato rrethana të kohës nuk është se ka çuar peshë shumë
8 terminologjia, por si shërbim informativ mendoj se është
9 formuar pas themelimit të Qeverisë së Përkohshme.

10 PY. Faleminderit për sqarimin. A mund të sqaroj lidhur me atë
11 se çfarë na thanë si përgjigje, që në atë kohë nuk ka pasur
12 raporte të ZKZ-së lidhur me këtë rast konkret. E kam fjalën
13 për rastin e z. Shala. Pra, thjesht bëhej fjalë për
14 informacion që ju e keni marrë nga z. Baftiu. A është kështu,
15 Dëshmitar? Është e saktë kjo?

16 PË. Duhet të sqaroj sepse fillimisht kisha përshtypjen që ky
17 raport është bërë kohë më herët, prandaj pata kërkuar do të
18 thotë kthimin edhe një herë në ekran të atij dokumenti, të
19 këtij kallëzimi penal për ta verifikuar datën, dhe pasi që e
20 verifikuam datën në atë dokument, atëherë erdhëm në
21 përfundimin se ky dokument është hartuar pasi që unë jam
22 emëruar në sektorin e ZKZ-së.

23 PY. Po, po e sqaruat këtë. Megjithatë, ajo çfarë dua të
24 sqaroj unë është kjo: Nuk ka pasur ndonjë raport nga ZKZ-ja
25 lidhur me këtë rast konkret. Por, ajo çfarë kishit ju ishte

1 thjesht informacion që ju ishte përcjellë juve prej z. Baftiu.

2 A është e saktë kjo?

3 PË. Kjo pjesë është e saktë. Po.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

5 nuk kam pyetje të tjera për dëshmitarin.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 Znj. Alagendra.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ndërkohë që është këtu

12 akoma dëshmitari, dua të them që ka një gabim në transkript.

13 Është një faqen 69 dhe do të pres për udhëzimet tuaj, të

14 nderuar Gjykatës. Në rreshtin 14.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta do

16 ishte më mirë që të bënit kërkesën dhe t'i kërkonit përkthyesve

17 të bëjnë verifikimin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e bëjmë

19 dot nga këtu.

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull, ashtu do bëjmë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi,

22 mbërritëm në fund të dëshmisë tuaj. Lejoheni që të largoheni

23 nga Gjykata. Ju falënderojmë që ishit me ne dhe që ndatë

24 informacionin që dinit. Ju urojmë gjithë të mirat.

25 DËSHMITARI: Faleminderit.

1 [Dëshmitari largohet]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
3 tjetër gjë për t'u trajtuar.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo për t'u trajtuar, por thjesht
5 dua që t'ju kërkoj që përderisa bëhet fjalë për një klient që
6 do japë dëshmi përmes videolidhjes kërkojmë që t'i jepet leje
7 klientit tonë që të ndjekë seancën përmes videolidhjes nga
8 paraburgimi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Pa problem. Ne do fillojmë në orën 11.00 nesër. Do bëjmë dy
11 orë seancë, nga ora 11.00 deri në orën 12.00 me 15 minuta
12 pushim. Pastaj nga ora 12.00 deri në orën 1.00, dhe në qoftë
13 se është e nevojshme pastaj do jemi -- do e mbyllim deri sa të
14 përfundojmë.

15 Me ç'kam kuptuar ju thatë që keni nevojë vetë për 45
16 minuta.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj që do jetë shumë më pak
18 sesa kaq. Megjithatë mendoj që ju thatë dje 11.30 jo 11.00.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Oh, ashtu,
20 vërtetë:

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj që këtë kam -- këtë kam
22 dëgjuar dje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, keni të
24 drejtë. Është 11.30 jo 11.00.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po ja u bëj këtë pyetje sepse disa

1 prej nesh kanë planifikuar që të largohemi nga Haga nesër.

2 Duhet ta dimë.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, edhe ne kemi
4 shumë pak pyetje.

5 Z. TULLY: [Përkthim] Ne ndoshta do të kemi 10, 15 minuta.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne mbase të njëjtën kohë, mbase
7 deri në 30 minuta.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne po aq kemi, 10, 15 minuta.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Do e mbyllim këtu sot. Nesër do fillojmë në orën 11.30.

11 --- Seanca mbyllet në orën 15.29

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25